

# Akoma nuk keni një website?

Akoma nuk jeni regjistruar në Google

Për çdo konsultim mund te vini në çdo kohë në zyrat tona

Adresa e zyrave: 30 Avenons Road, London, E13 8HT  
Tel:020 7018 7929 Mob: 073 4066 5946 Mob:078 5997 7545



*The* **Albanian**

VITI I 20 I BOTIMIT 25 PRILL 2024

Tel: 020 7018 7929 30 Avenons Road London E13 8HT

## ANGLIA MIRATON LIGJIN PËR DËBIMET: EMIGRANTËT E PARË DËRGOHEN NË RUANDA NË KORRIK



**PETRIT KUÇANA**  
**PSE NUK E**  
**REGJISTRUAN**  
**DIASPORËN**  
**SHQIPTARE?**



**ARBEN MANAJ**  
**GAZETAREN E BBC E VRAU**  
**"LEGIJA"?**  
**MEDIAT BRITANIKE**  
**AKUZOJNË KRIMINELIN**  
**SERB QË VRAU GJINGJIÇ**  
**DHE STAMBOLIÇ**

**ÇËSHTJA E REFUGJATËVE**  
**SHQIPTARË NË SERBINË**  
**E VITIT 1879**

**DAUT DAUTI**



**FYTYRA E BURRËSHETASVE**  
**HAJDUT E SHPËRFAQ**  
**PAFYTYRËSINË E ELITAVE**  
**SHQIPTARE**

**KIM MEHMETI**



**KUR DO KETË TIRANA**  
**GUXIMIN T'I KUJTOJË ATHINËS**  
**GJENOCIDIN GREK NË**  
**SHQIPËRI NË 1914?**

**SHABAN MURATI**



**SPIRALJA**  
**E RREZIKSHME**  
**E PËRSHKALLËZIMIT**

**DITMIR BUSHATI**



**"VEÇANTIZMI", GROPA**  
**NË TË CILËN**  
**PO ZHYTET SERBIA**


**VETON SURROI**



**E ARDHMJA FILLON TANI**

**Dotech**  
websites

**JEPI FRYMËMARRJE**  
**BIZNESIT TËND**



**PËR ÇDO KONSULTIM**  
**MUND TE VINI NË**  
**ZYRAT TONA**

**ADRESA E ZYRAVE:**  
**30 AVENONS ROAD**  
**LONDON E13 8HT**

**020 7018 7929**  
**073 4066 5946**  
**078 5997 7545**


The Albanian newspaper in London

**THE ALBANIAN**  
www.thealbanian.co.uk

www.thealbanian.co.uk

albania7@gmail.com

Tel: 020 7018 7929



### PETRIT KUÇANA

Zëvendës ministrja për Punët e Jashtme dhe Diasporën e Kosovës znj. Liza Gashi njoftoi se 180 mijë mërgimtarë të regjistruar deri tani në platformën eDiaspora. Kushdo që ka ndjekur zhvillimet nga Kosova për diasporën, me siguri do të mbetet i befashuar kur e krahason me Shqipërinë amë. E mbase do ta ketë tepër të vështirë të gjejë një

## PSE NUK E REGJISTRUAN DIASPORËN SHQIPTARE?

qoftë edhe një arsye për të kuptuar se përse diaspora e këtij Drinit nuk është regjistruar. Gati të pabesueshme do të kishte të kuptonte se pse emigrantët shqiptarë nuk votojnë në vendet ku jetojnë siç e ka çdo vend i Evropës dhe më gjerë.

Pra shqiptarët e Shqipërisë janë të vetmit që nuk votojnë në vendet ku jetojnë.

Do të ngjante cinike nëse do të pyesnim se sa dekada do i duheshin një force politike në pushtet për të regjistruar shtetasit e saj nëpër botë?

Në 12 vitë në pushtet nuk kemi parë qoftë edhe një iniciativë konkrete qoftë edhe në këtë drejtim. E madje diaspora dalëngadalë u hoq edhe nga fjalori i përditëshëm politik, u hoq si term i pavlerë, sidomos pas shkrirjes së Ministrisë së Diasporës, ndonëse besohet se të paktën 1.7



milionë shqiptarë jetojnë në diasporë. Akoma nuk kanë dalë rezultatet e Censurit duke hapur shumë dilema mbi numrin e popullsisë në Shqipëri, por besohet se ka patur një zbrastje të Shqipërisë sidomos gjatë këtyre viteve të fundit. Vetëm në Britaninë e Madhe në tre-katër vitet e fundit besohet se kanë hyrë

mbi 40 000 shqiptarë. Vazhdohet të mos ketë shifra të sakta dhe kushedi edhe sa kohë do të kalojë derisa dikush të kujtohet se nuk është edhe aq keq që diaspora, pra shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë Shqipërisë të regjistrohen, së paku të dihet numri. Kushedi sa do të sjellin ndërmend nenin 8 të Kushte-

tutës pra si detyrim shtetëror, e mbase mbase do të ndalen tek ndonjë statistikë e bankës së Shqipërisë mbi të ardhurat nga remitancat.

Për çdo shtet, për çdo shoqëri, diaspora mbetet aset tepër i çmuar, por duket se për shtetarët shqiptarë kjo nuk ngjet të ketë ndonjë interes. I vetmi moment mbetet para zgjedhjeve, ku partia në pushtet mobilizon kryesisht autobusët dhe militantët me patronazhistë dhe i sjell për të votur. Këtu mbaron edhe 'puna' me diasporën. Më e çuditshmja është se kryeministri paska parashikuar edhe një tur. A nuk është kujtuar vonë? Apo 'mka çu nana me la gojen'?

A do të votojë diaspora në zgjedhjet e ardhshme? Gjasat janë që jo. A do të japë llogari Rama për këtë? Çdo gjë tjetër mbetet thjesht në funksion të propagandës.

## AVOKATET E EMIGRACIONIT PER SHQIPTARET NË UK

**HA** Haris Ali Solicitors

If you are a child born in the UK with no immigration status, after 7 years in the UK you can apply straightaway for indefinite leave to remain (ILR).

Call: 0208 8570 7300 | Mobile: 07967 467414 | [www.harisalisolicitors.co.uk](http://www.harisalisolicitors.co.uk)

19 Kingsley Road, Hounslow, London. TW3 1PA

# IMPERIUM CHAMBERS

(ZYRE LIGJORE ME BARISTER TE KUALIFIKUAR PREJ 25-VITESH)

A JENI KONFUZ NGA  
NDRYSHIMET E SHUMTA  
LIGJORE TE EMIGRACIONIT DHE  
KENI NEVOJE PER NDIHME DHE  
QARTESI?!

-NUK JENI  
VETEMI!

Tel 1: 07901181592

Tel 2: 02072423488

Address: Thanet House, 231-232  
Strand, Temple, London,  
WC2R 1DA

## NE JEMI TE SPECIALIZUAR NE CDO FUSHE TE EMIGRACIONIT

DHE OFROJME NDIHME ME GJITHCKA PERFSHIRE:

Refuzimin e azilit pa te drejte gjyqi  
Aplikime/ri-aplikime nga e para  
Apelime ne te gjitha gjykatat  
Bashkime familjare ose visite ne uk



TELEFONONI **ADELEN** NE **07901181592** PER T'U KONSULTUAR



**Keni nje Bizness qe po rritet?**

**DONI TE MERNI PUNETOR NGA SHQIPERIA NE  
ANGLI?**

TE SPECIALIZUAR NE

**BUSSINESS IMMIGRATION**  
OFROJME APLIKIM TE SIGURTE PER  
**SPONSORSHIP LICENSE**

Bizneset perfshijne:


Kompani ndertimi  
Restorante/café  
Car washes

Care homes  
Office work  
Berber

**\*DHE SHUME BIZNESE TE TJERA**

SHERBIMET QE OFROJME:

- Human Rights
- Judicial Review
- Appeals
- Fresh Claims
- Asylum
- Overstayers
- Stateless
- Detention and Bail
- EEA Family Permit
- ILR/Natyratisation
- Change of Nationality from Kosovan to Albanian
- Work and Student Visa
- Spouse Visa
- Visitor Visa
- Divorce



Email:  
adela.bushi@imperiumchambers.co.uk  
enquiries@imperiumchambers.co.uk  
Website:  
www.imperiumchambers.co.uk  
YouTube:  
The Immigration Barrister

## “NË POST, POR JO NË PUSHTET”/ANALIZA E CNN: DY JAVË PARA ZGJEDHJEVE, GJËRAT DUKET SE PO SHKOJNË KEQ PËR KRYEMINISTRIN BRITANIK SUNAK! RREZIKON HUMBJE KATASTROFIKE

Dy javë para zgjedhjeve lokale në Britani që pritet të shkojnë keq për partinë e tij konservatore, ka një ndjesi të përgjithshme se Sunak është kryeministri që i përshtatet më mirë epiteti “në post, por jo në pushtet”, shkruan rrjeti CNN.

Kryeministri konservator i pazgjedhur Sunak, ka thënë se do të mbajë zgjedhje të përgjithshme në Britani këtë vit, por nuk ka përmendur data. Zhurmat thonë se ai po mbahet sa të mundet në pushtet për të evituar një humbje katastrofike të konservatorëve pas një dekade me “politika që nuk kanë lënë asnjë shenjë”, shkruan CNN. Problemi për Sunak është se çdo gjë që ai bën, i rikthehet për ta goditur si një bumerang, në një mënyrë ose një tjetër.

Kësaj jave ai nisi në Britani nisimën e papritur për të ndaluar duhanin, që u aprovua nga senati i vendit, me njëfarë mbështetjeje nga opozita laburiste. Por dy pararendësit e tij konservatorë e vinin në lojë. Boris Johnson tha në një audience në Kanada: “Ne jemi partia e Winston Churchill dhe tani

kërkojmë të ndalojmë purot [cigaretet]? ‘Donnez-moi un break’, siç i thoni ju këtu në Kebek. Është çmenduri.” Edhe ish-kryeministrja ‘më jetëshkurtër’ e Britanisë, Liz Truss, e quante masën e Sunak “legjislacion vetëm për sinjalizim virtuti.”

Në total, rreth gjysma e deputetëve të Sunak nuk e kanë mbështetur masën duke shfaqur një ndarje të rrallë të konservatorët dhe duke kthyer në qesharake partinë në pushtet, sipas ekspertëve vendas.

Kësaj jave inflacioni në vend ishte në rënie dhe politikat e tij për emigracionin po i afroreshin më shumë realitetit për t’u kthyer në ligj.

Por përsëri mediat nuk duket se i dhanë shumë rëndësi “sukseseve” teksa axhenda politike dominohej nga libri i prituri i kujtimeve dhe zbulimeve të ish-kryeministres Truss, pararendësja e kontestuar e Sunak.

Muajin e kaluar një nga krerët



konservatorë, Lee Anderson u nda nga konservatorët për t’u bashkuar me rivalët e djathtë ‘Reform UK’, edhe pse ishte një nga aleatët kryesorë të kryeministrit.

Megjithëse Anderson ka qenë më parë edhe laburist, ai besohet se ka tërhequr shumë të tillë me vete kur kaloi te konservatorët në in 2019.

Anderson u pezullua nga konservatorët pas komenteve për kryebashkiakun musliman të Londrës, Sadiq Khan, që nuk u pëlqyen nga Sunak.

Ndërsa më herët kryeministri kishte shkarkuar ministren e brendshme Suella Braverman, pasi ajo shkroi një artikull ku kritikonte policinë vendase ‘pa miratimin e shefit’.

Pas shkarkimit, Braverman akuzonte Sunak për “tradhti” në lidhje me politikat e emigracionit në Britani.

CNN shkruan se megjithëse Sunak mund të ngajë si një konservator i butë, autoriteti i sa vjen e gërryhet, nëse ka ekzisuar ndon-

jëherë, siç thotë dhe një ish zyrtar i partise: “Konservatorët duken si të vdekur. Nuk kanë mundësi ringritjeje dhe Rishi përcillet në publik me imazhin e të papëlqyerit, të pazakontit ose acaruesit.”

Në një tjetër zhvillim, javës që vjen politikat e kampeve të refugjatëve në Ruanda do të kalojnë në parlament, duke shpresuar që ligji të reduktojë fluksin e migracionit me gomone nga Franca, që kanë pasur një rritje prej 56% në tre muajt e parë të 2024, sipas agjencisë evropiane Frontex.

Por votuesit kërkojnë rezultate të dukshme dhe për këtë nuk ka kohë deri në zgjedhjet e ardhshme.

Sunak gjithashtu mund të ofrojë ulje taksash ose oferta të tipit të partive të djathta, që përsëri pritet të vihen në lojë nga personazhe të larguar konservatore si Braverman e Truss. top channel

HA  
HARIS ALI SOLICITORS

# KONSULTIMET FALAS

OFFICE: 020 8570 7300 / MOBILE: 07967 467414

We are **Immigration Experts** who have a high success rate in representing thousands of **Albanian** clients with a variety of immigration issues. We have a highly experienced team of immigration solicitors and barristers.

- Asylum / Trafficking
- Overstayers / Human Rights
- Detention & Bail
- Appeals & Judicial Review
- Fresh Claims / Further Submissions
- Indefinite Leave To Remain / Nationality
- EEA Permits / Stateless / Deprivation
- Spouse Visas / Children's Visas

Email: [contact@harisalisolicitors.co.uk](mailto:contact@harisalisolicitors.co.uk)

19 Kingsley Road, Hounslow, London, TW3 1PA | [www.harisalisolicitors.co.uk](http://www.harisalisolicitors.co.uk)

Në ambientet e Ambasadës së Republikës së Kosovës në Londër u bë promovimi i librit të shkrimtarit dhe mikut të madh të shqiptarëve prof. John Hodgson – E ardhmja në të kaluarën: Kujtime të Kosovës.

Në vitet 1980-1984 John Hodgson ishte lektor i Këshillit Britanik pranë Degës së Anglishtes në Universitetin e Prishtinës, ku mësoi shqipen dhe iu përkushtua thellësisht gjuhës shqipe.

Ai ka përkthyer vepra të Ismail Kadarese dhe të Fatos Lubonjës nga shqipja në anglisht.

Libëri i tij “E ardhmja në të kaluarën: Kujtime të Kosovës” shpalos historinë se si shkoi në Kosovë, si e njohu Kosovën, si e njohu gjuhën tonë, popullin, kulturën, e mbi të gjitha urën lidhëse që me anë të përkthimeve ka krijuar mes shqipes dhe anglishtes, me një shqipe të pastër e tejet të këndshme.

Siç u cek nga të pranishmit, tregimet në libër janë një përshkrim i saktë dhe i detajuar i ngjarjeve e rrethanave të zhvilluara (edhe politike) në vitet e 80-ta.

## Promovohet “E ardhmja në të kaluarën: Kujtime të Kosovës”



Ambasadori Kapiti falenderoi Autorin, Ambasadorin e Shqipërisë z. Ferizi dhe të pranishmit të cilët ishin në numër të kon-

siderueshëm në promovim të këtij libri, ku një pjesë e tyre komentuan edhe përshtyp-

jet e tyre dhe vlerësimet për botimin e këtij libri të prof. Hodgson



**GOLDFIELD**SOLICITORSLLP

**41d Kilburn High Road  
London NW6 5SB  
Tel: 020 7372 1966**

**We offer competitive prices for our range of services**

**Immigration & Nationality**

**Criminal Cases**

**Family Law**

**Residential  
Landlord  
and Tenant & Commercial  
Properties**



**Për më shumë informacione në  
gjuhën shqipe kontaktoni Suelën  
Mob: 07384295934**

# ÇËSHTJA E REFUGJATËVE SHQIPTARË NË SERBINË E VITIT 1879

DAUT DAUTI

Në fund të korrikut 1879, funksionari i lartë otoman, Karateodori Pasha, i kishte dërguar një telegram Legatës Otomane në Serbi që kishte të bënte me kthimin e refugjatëve shqiptarë në këtë vend.

Çështja e përshkruar në këtë telegram ishte aq e zbehtë sa që përfaqësuesi otoman në Serbi nuk e kishte të qartë se çka duhej të bënte. Këtë çështje kishte kërkuar ta nxirrte në pah përfaqësuesi britanik, Gould, por otomanët edhe me këtë përgjigje nuk ndihmuan në sqarimin e plotë në lidhje me atë se çka kërkonte Porta dhe cilat ishin masat që duhej ndërmarrë në lidhje me problemin e refugjatëve shqiptarë në qarqet diplomatike dhe brenda qeverisë së Serbisë.

Gouldi, sipas instruksioneve të Londrës, nuk pushoi të reagoonte në adresë të Ministrisë së Jashtme të Serbisë për shkak të keqtrajtimit që ky shtet ua bënte popullsisë myslimane. Edhe me 18 korrik, Gouldi ia përkujtoi Ristiqt se Fuqitë e Mëdha, të cilat e garantonin pavarësinë e Serbisë, nuk e shihnin me sy të mirë keqtrajtimin e myslimanëve në këtë shtet. Ristiqi e luti Gouldin që Londra të mos merrte ndonjë vendim të shpejtë pasi që ai premtoi se kjo çështje do të shikohej seriozisht nga Beogradi dhe se do të



menjanohehin shkaqet e ankesave. Ministri serb shtoi se për këtë çështje nuk mund të akuzohej vetëm Serbia. Sipas tij, faji ishte edhe i myslimanëve pasi që ata nuk mund të adaptoheshin në ndryshimet e reja dhe se nuk u pëlqente që të qeveriseshin nga serbët e krishterë. Sipas Ristiqt, kjo ishte arsyeja e shpërnguljes masive të myslimanëve edhe pas përfundimit të luftës.

Për shkak të brutaliteti serb, myslimanët tashti po shikonin të gjenin mundësi të shitjes së shpejtë të pa-

surive dhe të iknin sa më parë nga Serbia. Si rezultat i kësaj gjendjeje pasuritë e patundshme kishin vërshuar tregun serb në të cilin kishte fare pak blerës.

Në Beograd përfaqësuesi otoman, Sermed Efendi, me 22 korrik ia tregoi një telegram përfaqësuesit britanik. Në telegram, të cilin e kishte dërguar Karateodori Pasha, thuhej se Porta e Lartë kishte informata se Serbia ishte duke përgatitur një sulm ushtarak për të depërtuar në Prizren. Gouldi nuk i besoi këtij lajmi dhe

duke u bazuar në të dhënat e tij, e diskualifikoi këtë informatë. Ai e dinte se në rajonin e Nishit, prej nga thuhej se do të nisej sulmi kundër Kosovës, serbët kishin diku rreth 9000 deri në 10 000 ushtarë të rregullt kurse projekti i formimit të ushtrisë rezervë nuk kishte kaluar në Skupshtinë për shkak të mungesës së fondeve.

Si kundërpërgjigje, me 31 korrik Ristiqi lajmëroi se qeveria e tij kishte informata të besueshme se po bëhej një agjitim i madh në Shqipërinë Veriore. Ai i tha diplomatit britanik se prijësit shqiptarë i kishin mbledhur klanet për t'u këshilluar për luftë. Sipas tij, shqiptarët po përgatiteshin për ta sulmuar Serbinë.

Ristiqi shtoi se shqiptarët nuk do të mund të ndaleshin as nga forcat otomane edhe sikur ato të dëshironin pasi që numri i tyre rreth kufirit me Serbinë ishte i vogël dhe përbehej

vetëm nga dy batalione. Ristiqi kërkoj nga Gouldi që qeveria britanike ta shqyrtonte këtë çështje te sulltani në Stamboll e pastaj të arrestoheshin prijësit shqiptarë. Gouldi nuk ndërmori ndonjë hap në këtë drejtim pasi që nuk u bazua në këto informata të Ristiqtit.

Por, Gouldi ia përkujtoi edhe një herë Ristiqt çështjen e refugjatëve shqiptarë. Gouldi theksoi se pritej që së shpejti çështja të merrej në shqyrtim edhe nga përfaqësuesi gjerman në Beograd. Në këtë iniciativë diplomati gjerman ndihmohej nga kolegu i tij austro-hungarez, i cili ishte në pritje të një raporti që së pari do të miratohesh nga Princ Bizmarku dhe Kont Andradi. Gouldi i tha Ristiqt se çështja e refugjatëve shqiptarë tashti po përkrahej edhe nga komisionari Velini, anëtar i Parlamentit Italian. Velini kishte vendosur t'ia thoshte Ristiqtit të vërtetën për rrezikun e kufirit të Serbisë nëse qeveria e Beogradit nuk pajtohej për kthimin e shqiptarëve në shtëpitë e tyre. Dhe jo vetëm kaq, Velini i sugjeroi Ristiqtit që Serbia duhet t'ju siguronte shqiptarëve një nive të lartë të autonomisë.

Pjesë nga libri im që shihet në foto. Faqe 96 – 99:



**Apollonia Transport**

**TRANSPORT MALLRASH**  
**ANGLI - SHQIPERI**  
**SHQIPERI - ANGLI**



**SHQIPËRI**

Tiranë - Durres-Elbasan-Berat  
Fier-Vlorë-Roskovec-Ballsh



**BRITANI**

Londër - Birmingham  
Manchester - Leeds - Luton

**NA KONTAKTONI**

**UK: 00447429200952**

**AL: 00355682948843**

**AL: 00355694031009**




**TRANSPORT SHQIPERI - ANGLI**



**+44 7741 588799**



**+355 67 728 2828**

**SHQIPËRI**

- Elbasan
- Tirane
- Shkoder
- Lezhe
- Laç
- Fushe Krujë
- Lushnjë
- Berat
- Poshnjë
- Belsh

**ANGLI**

- Londër
- Manchester
- Sheffield
- Leeds
- Birmingham
- Coventry
- Luton
- Oxford
- Northampton

**Për oferta speciale ju lutem na kontaktoni në çdo kohë**

Ju Faleminderit qe na besoni!



ARBEN MANAJ

Pa mbaruar mire ping-pongu mes Parlamentit britanik dhe Dhomes se Lordeve kur me ne fund konservatorët e kryeministrit Sunak me shumicën parlamentare miratuan planin e tyre të debatueshem për dergimin e emigrantëve të ardhur me gomone drejt shtetit afrikan të Ruandes 5 viktima të reja, mes tyre një grua dhe një femije kanë humbur jetën këtë të martë në ujrat e La Manshit, në tentativën për mbritjen në brig-

jet angleze, ku sot qindar emigrante të rinjë kanë mbritur me gomone.

Plani i Ruandes nënkupton që të ardhurit me gomone do të dergohen në Ruandë 9 orë larg me avion nga Londra, për tju shqyrtura atje kërkesat e tyre.

Në këtë plan nuk përfshihen emigrantët që ardhur nga Shqipëria pasi Londra dhe Tirana kanë marrëveshje për riatesimin e tyre të arritur mes Rames dhe Sunak në Londër përparë dy vjetësh.

Kjo skemë u propozua fillimisht nga Boris Johnson përparë dy vjetësh për të frenuar ardhjen dhe kalimet e rrezikshme në La Mansh



te emigrantëve. Sunak e ka ndër pesë pikat e tij në prag të zgjedhjeve të reja të kesaj vjeshte, frënimin e kalimeve ilegale sidomos përmes detit.

Por koha për të pasur sukses duket e pakët deri në zgjedhjet e reja. Fluturimet drejt Ruandes nuk priten të fillojnë deri në korrik ndoshta

edhe më tej, pas sfidave të mundshme ligjore, apo edhe nderhyrjesve potenciale të Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut.

Complete  
glasses from  
just £15

Includes standard  
single-vision lenses only



That's what you call face value

Ask in store for details or go to [specsavers.co.uk](https://www.specsavers.co.uk)

You're better off with

Specsavers

ARBEN MANAJ

Një person i kërkuar për t'u marrë në pyetje në lidhje me vrasjen e gazetares së BBC, Jill Dando, ka një ngjashmëri të frikshme me vrasësin mizor të shërbimeve sekrete serbe, Milorad Ulemek, ka zbuluar një hetim i gazetës "The Mirror" të Londrës.

Një person i paidentifikuar u kap nga kamerat e sigurisë në rrugën, që ka ndjekur vrasësi i shërbimeve sekrete serbe, pas vrasjes në 1999 të gazetares së BBC, pasi ajo apelonte për t'u ardhur në ndihmë refugjatëve nga Kosova të shpërngulur nga masakrat e ushtrisë së Milloshevit në Kosovë, kur avionët e Britanisë dhe të NATO-s godisnin objektivat serb gjatë asaj fushate ajrore ushtarake.

Nga hetimet, del se "Personi X" i dyshuar dhe i kapur nga kamerat e sigurisë ka ngjashmëri të madhe me vrasësin serb, i cili është duke vuajtur 40 vjet burg në burgun e Zabelas të quajtur Alkatrzi i Serbisë në afërsi të qytetit lindor të Prozarevacit. Vrasësi Ulemek është dënuar për vrasjen e ish-presidentit serb, Ivan Stambolic në 2000 dhe ish-kryeministrit Zoran Gjingjic në 2003-in.

## GAZETAREN E BBC E VRAU "LEGIJA"? MEDIAT BRITANIKE AKUZOJNË KRIMINELIN SERB QË VRAU GJINGJIÇ DHE STAMBOLIÇ



Ai njihet me nofken Legija dhe është ushtaraku paramilitar më famëkeq, ndërkohë që grupet e të drejtave të njeirut thonë se njësia e tij, është përgjegjëse për disa nga mizoritë më të tmerrshme në luftat jugosllave të viteve '90.

Gazetarja e BBC Jill Dandio, 37-vjeçare, është vrare nga afër përpara derës së shtëpisë së saj sapo ajo doli nga makina e saj BMË.

Kanë kaluar 25 vite nga vdekja e saj dhe Policia Metropolitane thotë se hetimi për vrasjen e

gazetares është joaktiv, por për vrasje të pazbuluara, hetimet kurrë nuk mbyllen dhe dedektivët do konsiderojnë çdo informacion të ri të ofruar. Sakaq, avokati i vrasësit serb, Ulemek, Aleksander Kovacevic, tha se klienti i tij nuk dëshironte të merrte pjesë, ku u

pyet nëse ai e kishte vrarë gazetaren e BBC, Jill Dando, dhe shtoi se klienti i tij është informuar për rastin dhe se nuk është i interesuar për të marre pjesë në hetimet e reja.

## 180 MIJË MËRGIMTARË TË REGJISTRUAR DERI TANI NË PLATFORMËN EDIASPORA

Zëvendës ministrja për Punët e Jashtme dhe Diasporën e Kosovës znj. Liza Gashi gjatë një konference për media së bashku me U.d. së Kryeshefit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), z. Avni Kastrati deklaroi se deri më sot janë regjistruar në platformën eDiaspora 180 mijë shqiptarë që jetojnë në Diasporë.

Ajo theksoi se Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në mbështetje të plotë procesit të Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave – ReKos 2024, dhe në mbështetje të ASK-së, po vazhdon procesin e regjistrimit online të pjesëtarëve të Diasporës. "Regjistrimi online i mërgatës sonë, po ndodh për herë të parë, dhe është proces i integruar në platformën ediaspora.rks-gov.net, që është iniciativë e MPJD-së për të mbështetur bashkatdhetarët tanë me shërbime të digjitalizuara, dhe njëherë për t'i afruar me vendin amë.

Ritheksova se pjesëmarrja e bashkatdhetarëve tanë në procesin e regjistrimit të popullsisë është jashtëzakonisht e rëndësishme ngase na ofron një pasqyrë të qartë të shpërndarjes së qytetarëve tanë nëpër botë, dhe përmes kësaj një mundësi më të madhe që të përfshijmë ata, përmes të dhënave që ofrojnë, në proceset e hartimit të politikave, strategjive e shërbimeve më të mira dhe përkitazi me nevojat e tyre" tha ndër të tjera Gashi.

Nëpërmjet platformës eDiaspora, shtetasit e Kosovës mund të regjistrohen nga cilido vend i botës, duke dëshmuar përmes këtij regjistrimi se ata janë pjesë e barabartë e shoqërisë së Kosovës.

"Pjesëmarrja e mërgatës tonë në këtë proces është jashtëzakonisht e rëndësishme si për MPJD ashtu edhe për Republikën e Kosovës,



ngase për herë të parë na ofron një pasqyrë të qartë për vendndodhjen e bashkatdhetarëve tanë si dhe kërkesa e tyre.

Deri tani janë regjistruar 180 mijë pjesëtarë të diasporës, nga të cilët afër 50 mijë janë regjistruar në kuadër të platformës <https://ediaspora.rks-gov.net>" tha me tej Gashi,

duke inkurajuar të gjithë bashkatdhetarët që të shfrytëzojnë mundësinë përmes platformës eDiaspora dhe të regjistrohen.

# AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

Akoma nuk jeni  
regjistruar në Google?

**Dotech**  
website 

## Our Services:

- Business Cards
- Logos
- Banners
- Video Marketing

PËR ÇDO KONSULTIM  
MUND TË VINI NË ZYRAT TONA



**020 7018 7929**  
**073 4066 5946**  
**078 5997 7545**

**Adresa e zyrave:**  
**30 Avenons Road**  
**London E13 8HT**



## DËSHMIA TRONDITËSE/ STAFI I BIBBY STOCKHOLM NË BRITANI U TALL ME VDEKJEN E LEONARD FARRUKUT: NJË GOJË MË PAK MYSLIMANE PËR TË USHQYER

Sipas dëshmisë së një ish-pastruesja në anijen hotel ku Farruku kreu vetëvrasje, stafi i "Bibby Stockholm" i caktuar nga qeveria kanë qeshur dhe bërë shaka me vdekjen e tij.

Vdekja e të riut shqiptar, Leonard Farruku, në qendrat e emigrantëve në Britani vijon ende prej muajsh në vëmendjen e mediave britanike dhe shqiptare.

Sipas dëshmisë së një ish-pastruesja në anijen hotel ku Farruku kreu vetëvrasje, stafi i "Bibby Stockholm" i caktuar nga qeveria kanë qeshur dhe bërë shaka me vdekjen e tij. Ish-pastruesja Levana, e cila kishte punuar në qendrën e emigrantëve nga hapja e saj në gusht 2023 deri në fund të dhjetorit, tha në një takim në parlament se shumica e punëtorëve, tallenin duke thënë se kishte "një gojë më pak myslimane për të ushqyer".

"Shakaja e neveritshme, brenda një jave pas vdekjes së zotit Farruku, ishte klima e përgjithshme e shumë punëtorëve atje. Unë po filloja të mendoja: pse t'i vendosim këta njerëz që kanë këto pikëpamje dhe paragjykime në krye të kujdesit për qindra burra që kanë ardhur këtu për strehë të sigurt?", është shprehur Levana, shkruan BBC.

Takimi parlamentar u mbajt për të nisur një raport nga grupet që bëjnë fushatë kundër anijes hotel, duke përfshirë Care4Calais, Stand Up To Racism dhe Portland Global Friendship Group. Sipas këtij raportit, Levana pasi ka marrë masë disiplinore nga eprorët e saj është shkarkuar nga puna, me arsyetimin se ka biseduar



me refugjatët e strehuar aty.

"Më thanë se po më jepnin një paralajmërim verbal sepse nuk duhet të jem miqësor me përdoruesit e shërbimit në këtë mënyrë. Pas kësaj kam punuar edhe një turn të rezervuar dhe më pas

nuk më është ofruar më punë. Disa migrantë përshkruan se ndiheshin sikur ishin "në burg", ka treguar ajo.

Ndërkohë Zyra e Brendshme në Britani ka thënë se nuk i njeh këto pretendime të bëra në raportin e hetimit.

"Ne nuk i njohim pretendimet e bëra në këtë raport. Bibby Stockholm është pjesë e planit të qeverisë për të reduktuar përdorimin e hoteleve të shtrenjta. Ka procese rigorozë të mbrojtjes në maune. Banorët kanë akses në

shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe social, duke përfshirë mbështetjen e shëndetit mendor.", thuhej në deklaratën e tyre.

27-vjeçari shqiptar, Leonard Farruku ndërroi jetë në dhjetor të 2023 pa e ditur se ai kishte fituar të drejtën për të punuar në Angli e drejtë e cila iu dha nga Home Office. I ri shqiptar kishte mbërritur në Angli prej një viti dhe qëndronte në një azil në Bibby Stockholm. Ai u kishte paguar kontrabandistëve 4,000 euro për të shkuar në Britani ilegalisht me një varkë të vogël përtë Kanalit në gusht 2022. Më pas ai kishte kërkuar azil dhe kërkesa e tij po shqyrtohej në mënyrë aktive nga Zyra e Brendshme në kohën e vdekjes së tij më 12 dhjetor të vitit të kaluar.

Farruku kishte aplikuar për të punuar në një profesion me mungesë, siç lejohet sipas rregullave të Home Office dhe e kishte fituar. Lajm të cilin nuk arriti ta merrte arsye e cila ende mbetet e dyshimta pasi autoritet thone se disa ditë para vdekjes së të riut i ishte dërguar njoftimi.

Farruku dyshohet se i ka dhënë fund jetës në bordin e Bibby Stockholm në portin Portland, Dorset pasi u ankuar për shëndetin e tij mendor. Emigrantët e tjerë pretendojnë se kanë dëgjuar të bërtitura dhe përplasje në murin e kabinës së tij atë natë. dosja.al

## MEDIA ZVICERIANE: SHQIPJA MUND TË BËHET GJUHA E TRETË MË E FOLUR NË VEND

Gjuha angleze sikurse edhe ajo shqipe po fitojnë terren të ndjeshëm në Zvicër.

Këtë e thonë shifrat zyrtare nga Berna, raporton media zvicerane në gjuhë shqipe, Le Canton27.ch, duke iu referuar të dhënave nga Zyra Federale e Statistikave (OFS) në Neuchâtel.

Anglishtja si gjuhë kryesore po përparon dhe madje po zëvendëson italishten në podiumin e gjuhëve më të folura në vend.

Gjuha shqipe konsiderohet si një nga gjuhët më të popullarizuara në Zvicër.

Enti Federal i Statistikave ka raportuar se fundi se për herë të parë në më shumë se 10 vjet, më shumë njerëz në Zvicër flasin shqip se sa portugalisht.

Autoritetet zvicerane (OFS) pohojnë ndërkaq se italishtja nuk është më gjuhë e tretë në Zvicër, anglishtja e ka "rrëzuar" nga froni.

Por nuk mbaron me kaq. Anglishtja rrezikohet nga gjuha shqipe, raporton Le Canton27.ch.

Christoph Freymond nga Zyra Federale e Statistikave ka deklaruar se "numri i shqiptarëve është shtuar dukshëm në krahasim me komunitetet e tjera. Për çdo vit, qindra prej tyre natyralizohen, pra marrin pasaporta zvicerane".

Sipas Zyrës Federale, sot në Zvicër jetojnë dhe veprojnë mbi 300 mijë shqiptarë të cilët njihen si albanofonë, ku pjesa dërrmuese janë nga Kosova.

200 mijë shqiptarë nga Kosova jetojnë në Zvicër, 70 mijë janë nga Maqedonia e Veriut, 20 mijë nga Lugina e Presheës dhe më pak nga Shqipëria e Mali i Zi.

Autoritetet bëjnë të ditur se mbi 100 mijë shqiptarë janë natyralizuar dhe posedojnë pasaporta zvicerane.



Gjuhët që fliten në Zvicër

59.5% e banorëve të qyteteve zvicerane deklarojnë gjermanishten si gjuhën e tyre kryesore.

Nga pjesa tjetër, 22.8% frëngjishten.

Nëse marrim parasysh gjuhët jekom-

bëtare, shohim se anglishtja është zhvilluar ndjeshëm, duke përbërë sot gjuhën e tretë kryesore prej 8,1% të popullsisë rezidente, madje duke ia kaluar italishtes me 8%.

Përveç kësaj, rreth një e treta e njerëzve thonë se nuk kanë përkatësi fetare.

Pas katër gjuhëve zyrtare, prin gjuha

shqipe Plurilingualizmi po fiton terren në shtetit helvetik.

Dy të tretat e popullsisë përdorin rregullisht më shumë se një gjuhë në javë.

Të rinjtë flasin më shumë një gjuhë të dytë apo edhe të tretë.

Popullsia zvicerane po bëhet gjithnjë e më shumëgjuhëshe.

Kjo zbulohet nga sondazhi mbi gjuhët, fenë dhe kulturën, i kryer për herë të dytë nga Zyra Federale e Statistikave (OFS), ku shqipja renditet pas katër gjuhëve zyrtare në Zvicër.

Sipas të dhënave të reja të Zyrës Federale të Statistikave të siguruar nga gazeta zvicerane në shqip Le Canton27.ch, mbi 100.000 njerëz sot e flasin gjuhën shqipe në Zvicër.

Në përqindje, kjo nënkupton se 3.4 për qind e qytetarëve të Zvicrës flasin shqip.

**Dotech**  
website

# Porosisini BANNERIN TUAJ

**Me përmasa  
të ndryshme  
PVC Banners  
Mesh Banners  
Ofsted Banners  
Design + Post**



**IMPRESS EUROPE**  
**TRANSFORMING  
SPACES & CREATING  
DREAMS**

LEADERS IN  
CONSTRUCTION



**Our service :**

- Loft Conversion
- Extension
- Kitchen & Bathroom Refurbishment
- Plumbing
- Heating
- Electricals

☎ 07479611186 🌐 [www.impresseurope.co.uk](http://www.impresseurope.co.uk)

☎ 07733025619 ✉ [info@impresseurope.co.uk](mailto:info@impresseurope.co.uk)

**Për çdo konsultim mund të vini në zyrat tona**

**Adresa e zyrove:**

**30 Avenons Road London E13 8HT**

**Tel: 020 7018 7929**

**Mob: 073 4066 5946. Mob: 078 5997 7545**



**DISTRICT**

**CONSTRUCTION**

## Services

DESIGN & BUILD  
LOFT CONVERSION & EXTENSION  
KITCHEN RENOVATION  
BATHROOM RENOVATION  
REFURBISHMENT  
ROOFING  
GARDENING  
PLUMBING & ELECTRICALS  
PAINTING & DECORATING



[www.districtconstruction.co.uk](http://www.districtconstruction.co.uk)

[info@districtconstruction.co.uk](mailto:info@districtconstruction.co.uk)

Tel: 07780941795

KIM MEHMETI

# FYTYRA E BURRËSHTETASVE HAJDUT E SHPËRFAQ PAFYTYRËSINË E ELITAVE SHQIPTARE

Ja, së fundmi edhe dokumentari i RAI3 që tregon atë që e dinim, por që shtireshim se nuk e shohim: se si shtet, Shqipëria i ngjanë një organizate kriminale. Pra ja edhe një dëshmi se ne shtiremi që nuk e dimë se fytyra e burrështetasve tanë hajdutë e kriminelë e shpërfaq pafytyrësinë e elitave shqiptare.

E sa i përket heshtjes dhe pafytyrësisë së sotme të elitave shqiptare, ajo është melodi zbatimëse në krahasim me heshtjen e tyre katërdekadëshe përdërisa Xhaxhi Enver ua vriste shqiptarëve njerëzit më të vlefshëm që ata kishin.

Po pra, dokumentari i RAI3 nuk tregoi asgjë më shumë nga ajo që e dimë të gjithë sa jemi, shkrimtarë, shkencëtarë, profesorë, akademikë, mendimtarë të ‘pavarur’..., ne që shikonim



sehir kur rrënohej Teatri Kombëtar, ne që edhe sot shtiremi se nuk e dimë se,

për shembull, po t'i ndodhte bashkisë së Lubjanës që gjysma e drejtorëve të saj të përfundonin në burg për hajdutëri, atëherë atdhedashuria e banorëve të saj do e ‘kallte’ tërë qytetin.

Por te ne është krejt ndryshe. Ne shumëçka e dimë dhe e shohim, neve çdo gjë na thuhet hapur e pa frikë, por shtiremi se nuk dëgjojmë e nuk shohim gjë. Siç u shtirëm se nuk dëgjuam kur hapur na u tha se Piktori do na sundojë ‘ndershëm’ duke ardhur në pushtet me ndihmën e ‘aleancës së qelbësirave’?!

Dhe pasi erdhi në pushtet dhe e shpalli shtetin pronë të veten, ai shkoi përtej kësaj dhe na dëshmoi se nuk ka

njeri që nuk blihet, por vetën nëse nuk ia gabon çmimin. E kur jemi të çmimet, kuptohet se ai i të huajve është shumëfish më i lartë se i mendimtarëve shqiptarë që debatojnë nëpër mediat e ‘pavarura’ të Tiranës.

Pasi pra erdhi në pushtet dhe i mbushi xhepat e ‘Rilindjes’ me miliona euro, ai doli në tregun ku shiten e blihen elitare e njerëz të fuqishëm.

Dhe aty gjeti edhe shumë nga ata që kanë ekzistuar gjithmonë: të huaj me ndikim që shiten e blihen, të cilët të mësojnë si ta duash dhe mbrosh atdheun tënd, por ndërkohë duke i ndihmuar ‘blerësit’ e tyre – qeveritarët hajdutë që e rrënojnë atë.

# AKOMA NUK KENI BUSINESS CARDS?

NA KONTAKTONI:

020 7018 7929

073 4066 5946

078 5997 7545

PËR ÇDO KONSULTIM MUND TE VINI NË ÇDO KOHË NË ZYRAT TONA  
ADRESA E ZYRAVE: 30 AVENONS ROAD, LONDON, E13 8HT

The collage includes cards for:

- FD CONSTRUCTION**: Over 18 years of experience in building and refurbishment works. Phone: 020 7470 9922. Address: 41 Rymill Street, Victoria, London E15 2JF.
- LEO'S BAR & GRILL**: AUTHENTIC MEDITERRANEAN CUISINE. Address: 21 Church Lane, Leytonstone, London E15 1JG. Phone: 020 3788 7119.
- K ROOFING LTD**: NEW ROOF-LEAD WORK-FLAT ROOF. Exceptional results for our clients. Phone: 07927 214785 / 07477 867332. Website: www.kroofing.co.uk
- E&G STEELFIXING**: ADDRESS: 31 CROMWELL CLOSE EAST HITCHLEY WOOD. www.egsteelfixing.co.uk Phone: 07595 575280
- TUSHA CONSTRUCTION**: THE BEST OF CONSTRUCTION. Redcar Road, Ramford, England, RM3 9PX. Phone: 07492 248409
- B&B LONDON CONSTRUCTION LTD**: More information: 08002484752. www.bbcconstruction.co.uk
- OUR SERVICES**: Over 18 years of experience in building and refurbishment works. New Build, Loft Conversion, Extension, Kitchen and Bathroom, Paving & Landscaping.
- WE OFFER**: New Work, Lead Work, Felt Torch Roofing Systems, New Gutter, New Fascia & Soffit Roofing, etc.
- Services**: Concrete Structures, Columns & Walls, Concrete Slabs, Steel Fixing, Fabrication, Mesh, Ground Beams.
- OUR SERVICES**: Loft Extension, Refurbishment, General Building Work.
- OUR SERVICES**: CIVIL ENGINEERING & GROUNDWORKS, PAVING & LANDSCAPING, DRAINAGE, DRIVEWAYS & PATIOS, DEMOLITION.
- Our Services**: LOFT CONVERSION, EXTENSION, FULL REFURBISHMENT, PLUMBING & HEATING.
- Our Services**: Temporary Roof Systems, Gantry's and Loading Bays, Painters scaffolds, Access Towers, Chimney Stacks, Pavement Scaffolds, Birdcages, Internal High Status Scaffolds, Bricklayers Scaffolds.
- Services**: Temporary Roofs, Domestic Scaffolding, Industrial Access, Competitive Rates, Professional and experienced Scaffolders, Personalised services, All scaffolding work undertaken.
- BKB LANDSCAPE LTD**: 42 Devenay Rd, London, E15 4AY. Phone: 07450211425 / 07727635228
- ART CONSTRUCTION GROUP**: DISCOVER THE QUALITY. MANAGER: M. ROXHEJRI: 07476768895. DIRECTOR: P. OMERI: 07521731006
- Services**: EXTENSIONS, KITCHEN & BATHROOM REWIRING, ELECTRICALS, PLUMBING & HEATING, COFFER BEAMS, SALOONS, RESTAURANTS.
- MR BUILDING SOLUTIONS**: YOU DREAM IT, WE BUILD IT. +44 7828 079936. www.mrbuildingsolutions.co.uk
- Services**: LANDSCAPING, PAVING, DECKING, FENCING, BRICKS, SLABS, ARTIFICIAL TURF ETC.
- LALA SCAFFOLDING LTD**: Southern Arden Road Harnchurch, Ipswich, Suffolk. Phone: 02071 129374
- OUR SERVICES**: REFRUBISHMENT, EXTENSIONS & LOFT CONVERSIONS, GROUNDWORKS & FOUNDATIONS, DRIVEWAYS, PAVING, TILING, PAINTING & DECORATING, CARPENTRY, ELECTRICALS & PLUMBING, PAVING & LANDSCAPING, ROOFING, BRICKLAYING, STEELFIXING.

BUSINESS CARDS ME QR CODE

ZGJIDHNI PROFESIONISTËT PËR SUKSESIN E KOMPANISË TUAJ



ANDI BUSHATI

Skandali i shumëfishtë i telenovelës mes Edi Ramës dhe televizionit publik italian, po shpërfaq në perëndim një anë të panjohur të kryeministrit tonë në marrëdhëniet me mediat. Mënyra se si ai ka reaguar, telefonata arrogante që i ka bërë drejtuesit të RAI-t, përpjekja për të manipuluar opinionet e dy vendeve apo qoftë edhe vënia e vetes në linjën e parë të sulmit kundër programit investigativ "Report", ka patakur shumëkënd në Itali.

Disa të zgjedhur të vendit fqinjë, senatorë apo deputetë të komisionit të mediave, kanë folur publikisht për këtë ndërhyrje brutale ndaj një enti publik.

Edhe vetë autorët e emisionit vazhdo-

## TELEFONATA E EDI RAMËS ME DREJTUESIT E RAI-T, SI THIRRJA E NJË KAPO BANDE

jnë të deklarohen të tronditur nga sjellja e "nipit" që pavarësisht nga respekti për gjyshen e vet të ndierë, nuk e mirëkuptojnë dot.

Për të gjitha palët qasja e Edi Ramës është e denjë për një botë tjetër, që nuk ka lidhje me atë demokratike. Ajo është e papranueshme qoftë në formë edhe qoftë në përmbytje.

Le t'i marrim me radhë...

Në formë, asnjë kryeministër i një vendi normal, nuk e ngre telefonin të ndërhyjë te shefat, për punën e gazetarëve që veprojnë në liri dhe pavarësi të plotë. Natyrisht dhe në shtetet demokratike, yshtja për të ndikuar është e madhe. Por ajo bëhet në mënyra më të rafinuara, përmes personash të tretë, përmes kompanive apo kontakteve të "PR", që nuk lënë gjurmë direkte dhe jo nga vetë personazhet kryesore politike. Pikërisht për këtë, telefonatën impulsive të Ramës, zv drejtori i RAI-t dhe autori i programit, Sigfrido Ranucci, e krahasoi me ato të ministrit të jashtëm të Putinit, Lavrov, gjatë një interviste me Armela Ferkon.

Kjo tentativë sa arrogante aq dhe pasojë e instikteve të pa kontrolluara, është shokuese për cilindo që i njeh marrëdhëniet e komplikuara mes medias dhe politikës. Të gjithë e dinë se jo më një qeveritar, por edhe një padron ndërmarrjeje me më shumë se 20 apo 30 rogetarë, ia lë këtë punë në dorë zyrës së tij të mardhënieve me publikun. Mungesa e skrupujve për ta kthyer sherrin në personal, është ose karakteristike e diktatorëve të tipit Erdogan, ose më keq akoma, veti e bosëve mafiozë. Duke e kapur vetë telefonin, Edi Rama, zgjodhi të bëjë në gjaknxehtësi e sipër rolin e një kapobande.

Komportimi i tij është atipik edhe në përmbytje. Shumë gazetarë italianë i ka bërë të qeshin, mendësia autokratike për të barazuar kritikën ndaj një grupi qeveritarësh, ose edhe ndaj vetë kryeministrit me sterrosjen e imazhit të shqiptarëve. Ata janë tallur me manipulimin foshnjor të Edi Ramës, për ta reduktuar autopsinë e një shteti të kriminalizuar, në debatin nëse iu dha apo jo mundësia Engjëll Agaçit për t'u përgjigjur. Ata kanë qeshur me

akuzat për tendenciozitet dhe njëanshmëri, pasi janë rrefuzuar për intervista pikërisht nga njeriu që i anatemon sot.

Po pse rrëshkiti Edi Rama deri në këtë pikë? Pse cedoio ai, qoftë duke e personalizuar mënyrën e komunikimit, apo qoftë duke i banalizuar alibitë që tentoi të ngrinte?

Shpjegimi më i thjeshtë për këtë gjendet në batakun autokratik ku po vegjeton prej një dekade. Duke u sjellë si padroni real i shtypit në vend, duke paracaktuar vijën editoriale të TV ve kryesore, siç e dëshmuam edhe në rastin e emisionit "Report", lajmet e Top Channel dhe Klan, duke vendosur temat tabu që nuk duhet të prekin emisionet politike të mbrëmjes, duke përjashtuar nga konferencat e shtypit gazetarë si Klevis Muka apo çuar për "riedukim" Ambrozia Metën, duke mbyllur Agon Channel apo duke shembur me tritol investimet e pronarit të News 24, ai e ka humbur sensin e realitetit. Ai kujton se marrëdhëniet e një shtetari me median është raporti që ai ka vendosur me Vjollcën e Lori Kafesë apo të bijën që

e percepton politikën si Big Brother, me ish-Sandrin e Saliut, apo me të njëjtin Karlo që e trajton prej kohësh si pronë 1 euroshe.

Ambientimi me këtë perversitet, reflektet e kushtëzuara nga këto raporte të sëmurë, e kanë bërë Ramën të mendojë se gjërat zgjidhen me një urdhr në telefon. Se mjafton të flasësh me shefin, të shpikësh alibi foshnjore dhe realiteti mer ngjyrat dhe format që do ti. Prandaj ai i ra celularit për të komunikuar personalisht me shefin e RAI-t. Prandaj ai i'u drejtua në italisht publikut të vendit fqinjë me përalla qesharake me gjyshen.

Dhe në fakt këtu duhet gjetur një tjetër lajm brenda telenovelës mes kryeministrit tonë dhe entit publik italian. Kjo fabul tregon se Edi Ramës po i humbasin me shpejtësi receptotët e sjelljes në një mjedis demokratik. As dhe sa për sy e faqe, ai nuk i mbydot brenda vetes instiktet prej autokrati në raport me mediat. Pikërisht për këtë sjellja e tij prej kapobande i revoltoi shumë deputetë dhe gazetarë në brigjet përballë./LAPSI

### ADI KRASTA

Ajo çfarë mësoi publiku italian dhe një pjesë e publikut shqiptar nga programi investigativ i Rai 3, 'Hotspot Albania' është as më pak e as më shumë gjithçka që ne dhe ata pak gazetarë opozitarë në këtë vend kanë thënë e analizuar e faktuar ditë pas ditë e vit pas viti këto 12 vjet, për mënyrën se si është qeverisur ky vend nga ky grupim i dyshimtë politik që ka vendosur të qëndrojë ende, jo prej fuqisë, jo prej demokracisë, jo prej drejtësisë-por sepse janë të dënuar të largohen të vetëshembur nga e keqja e zullumi i tyre.

Nuk është e drejtë për këtë vend, por ama është krejt i merituar ky lloj shpagimi për ta.

Po çfarë thamë ne qysh në krye e për çka u sulmuam, u bëmë 'cancel' (u fshimë), u penguam, u shantazuam, u kërcënuam, u pushuam nga punët, u bëmë ushqim për hijet anonime në bodrumet e godinave publike me tituj, shkrime të porositur e fushata të organizuara në emër të linçimit politik.

1. Ne thamë se nëse një televizion kritik mbyllet arbitrarisht e sulmohet me procese artificiale politike si rasti i 'Agon Channel', precedenti është tejet i rrezikshëm për demokracinë dhe humbja e një gjyqi ndërkombëtar me shumta marramendëse është e sigurve. Çfarë ndodhi: Sot nga xhepat e

## GJITHÇKA THAMË KËTO 12 VJET OPOZITARIZËM, SOT ËSHTË KONFIRMUAR



shqiptarëve, jo të Edi Ramës, as të Velisë e as të mediave që i mbështesin nuk dalin ato lek. Janë 130 milionë euro të shqiptarëve të humbura.

2. Çfare u thamë ne ambasadorëve të momentit e atyre ndërkombëtarëve që janë zgjuar sot: u thamë se ky shtet nuk ka asfare ndërmend dekriminal-

izimin, përkundrazi, po zgjedh me cilët kriminelë do ndajë shtratin. Se precedentët antidemokratikë po përkeqësohen e se Evropa është larg. Nuk na dëgjuan.

3. Çfarë thamë në këto 12 vjet. Thamë që po kanabizohet vendi me një projekt të paramenduar. Sot pas një Min-

istri të Brendshëm të dënuar për lidhje me trafikantë, në çdo artikulum ndërkombëtar mediatik e politik, nën zë e nën zë - ky shtet konsiderohet Narkoshtet.

4. Thamë se me lekët e aktiviteteve kriminale po llobohet, po blihet media, partitë, individë, eminenca ndërkom-

betare-parlamentare, po blihet vota. Sot kemi në burg një agjent të FBI-së si dëshmia me përfaqësuese e një politikëdërje mafioze.

5. Thamë se po ju mbydot propaganda e se në shërbim të saj janë ushtri të tëra të paguara nga aktivitete korruptive të paprecedentë si inceneratorët e PPP-të.

6. Thamë se ka një projekt të sigurtë për zhbërjen e opozitës.

7. Thamë se reforma në drejtësi ka dështuar dhe askush nuk e mohan dot sot këtë..

8. Thamë se nuk ka dëshmi më të qartë për mënyrën se si ka qeverisur ky kryeministër e ky kryetar bashkie sesa dy fakte të pamohueshme. -1 milionë shqiptarë të larguar nga vendi si nga një tokë lufte dhe kullat e ngritura në kryeqytet.

Keto thamë e me shumë se kaq këto 12 vjet e sot gjithçka është konfirmuar.

## ARMAND SHKULLAKU

Qëndrimi aspak proporcional i disa ambasadorëve, mes batërdisë që ka ndodhur në bashkinë e Tiranës dhe disa tymueseve në dyert e saj, ka ngjallur një reagim të fortë tek ajo pjesë e qytetarëve që refuzojnë dhunën dhe korrupsionin e pushtetit. Reagim që ngërthente brenda dëshpërimit, zhgënjimit, revoltën. Përballë korrupsionit tronditës dhe unikal në Europë, a duhet të ishin ca shishe me benzinë shqetësimi më i madh i ambasadorëve të jashtëzakonshëm e fuqiplotë?

Pavarësisht ndjenjës së përzier që shkakton qëndrimi i ambasadorëve, ai është në vazhden e shërbimit ndaj pushtetit të Tiranës. E vetmja e veçantë këtë herë kishte të bënte me faktin se ashtuquajtura dhunë ishte aq e papërfillshme sa nuk e justifikonte shkallën e reagimit dhe koordinimit të menjëherëshme të përfaqësive të SHBA, BE e Mbretërisë së Bashkuar. E drejta e protestuesve prevalonte për së largu mbi shqetësimin për “dhunë”. Atëherë pse iu dha kaq rëndësi një ngjarje minore, ndërkohë që korrupsioni në bashki rezultoi në shkallë sipërore?

I vetmi shpjegim mund të jetë ai se ambasadorët, të paqtuar në ujërat e ndenjura të Rilindjes, i druhen prishjes së një statuskoje ku vegjetojnë mes burokracisë dhe dolce vita-s në raport me pushtetin e Tiranës. Ata nuk i shqetëson ajo dhunë, që në vendet e tyre as do të mbahej shënim, por ideja se një rritje e protestave mund të krijonte një situatë të re për të cilën as nuk janë dhe as nuk duan të jenë të përgatitur.

Të mësuar me një pushtet të gjatë, që garanton stabilitet duke asgjësuar demokracinë, me një opozitë që nuk po shfaq shenja fuqie për ta lëkundur regjimin e Tiranës dhe me një shoqëri civile të tredhur, ambasadorët, ashtu si një pjesë e madhe e shqiptarëve, duket se janë përshtatur me banalitetin



e së keqes. Disa nga dembelizmi e disa nga privilegjet, kanë preferuar të mbyllin sytë e veshët ndaj rrënimin të demokracisë në Shqipëri, që po i dërgon qindra mijë shqiptarë në vendet që ata përfaqësojnë. Më keq akoma, po i kthen në avokatë të pushtetit, në një nivel që nuk e kemi hasur kurrë në këto 30 vite.

Pra, kush ka pritur një qëndrim ndryshe nga ai i dënimit të “dhunës”, nuk ka kuptuar se shqetësimi i vërtetë i ambasadorëve është të mos prishet statuskuoja e stabilitetit dhe jo korrupsioni që i nxorri njerëzit para dyerve të bashkisë.

A nuk janë të njëjtën që ndonëse vetë BE e kritikoi ligjin special “Fusha”, nuk nxorren asnjë zë në sinkron me opinionion vendas e ndërkombëtar?

Janë po këta ambasadorë që u tronditën nga ca vezë mbi muret e bashkisë dhe heshtën për turp kur u shemb teatri kombëtar dhe u dhunuan aktivistët pro tij.

A kanë folur ndonjëherë për gazin lot-sjellës mbi qytetarët, kur vetë vendet e tyre e kanë dënuar përdorimin e tij në konventat europiane? A janë dëgjuar qoftë dhe një herë të shqetësohen për kërcënimet ndaj gazetarëve, ndonëse edhe Gjykata e Strasburgut i ka marrë në mbrojtje nga pushteti i Edi Ramës?

Konformimi i tyre me regjimin e Tiranës ka arritur në atë shkallë sa, kur nuk flasin për ngjarje të tilla flagrante, as mund të imagjinohet të mbajnë qëndrim për censurën e mungesën e transparencës që manifestohet në kronikat e gatshme ku dhe

ata vetë shfaqen me lopatë në dorë duke mbjellë ndonjë pemë.

Aq më pak për përdorimin e administratës e fondeve publike në fushata elektorale, abuzimin skandaloz me fondet e taksapaguesve europianë si në rastin e rindërtimit apo ndihmës për fermerët. Ambasadorët kanë kohë që e kanë ulur kokën edhe kur Rama iu sulmon SPAK-un apo iu gris marrëveshjet si ajo e 5 qershorit, kur ndryshoi sipas qejfit kodin zgjedhor për të mbajtur me çdo çmim pushtetin.

Qëndrimi i ambasadorëve nuk do të ndryshojë përse kohë pushteti i Tiranës garanton të ashtuquajturin stabilitet dhe opozita nuk ka forcën për ta krisur atë. Nëse protestuesit do të hynin në bashki apo do ta rrethonin

atë duke u ngujuar aty, nëse do të ishin shumë më tepër në numër dhe do nxisnin revoltë kudo ku ka padrejtësi, ambasadorët do të detyroheshin, me dhimbje, ta prishnin rehatinë rilindase.

Në vend të dënimit të dhunës, do të flisnin për kompromis, për negociata, për zgjidhje të krizës, për përgjegjësi dypalëshe etj.

Deri tani ndihen të sigurtë nën ombrellën e Ramës, se ngjarje të tilla janë larg së ndodhuri dhe bëjnë çmos edhe vetë që t'i largojnë sa më shumë. Prandaj njëzëri u shqetësuan për “dhunën” dhe jo krimin në bashkinë e Tiranës. Ata nuk kanë arsye ta prishin rehatinë, përse kohë vetë shqiptarët po e kërkojnë atë në vendet e tyre. ©lapsi.al

## POROSISNI BANNERIN PER BIZNESIN TUAJ

Jepini diapazon biznesin tuaj

### Te gjitha llojet

- PVC Banners
- Premium Roller Banners
- Pull Up Roller Banners
- Mesh Banners



Adresa e zyrave:  
30 Avenons Road, London, E13 8HT

Na kontaktoni:  
020 7018 7929  
073 4066 5946



# AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

## E nesërmja fillon tani!

**Dotech**  
websites 

## Jepi frymëmarrje biznesit tuaj!


Adresa e zyrave  
30 Avenons Road  
London E13 8HT

Për çdo konsultim mund te vini  
në çdo kohë në zyrat tona

**Dotech**  
websites 

Na kontaktoni:  
020 7018 7929

Mob:073 4066 5946 Mob:078 5997 7545



# Akoma nuk keni një website?

MUND TE VINI NË ÇDO KOHE NË ZYRAT TONA

## Akoma nuk jeni regjistruar në Google?

- ✓ BUSINESS CARDS
- ✓ BANNERS
- ✓ LOGO
- ✓ POSTERS
- ✓ VIDEO MARKETING

*The Albanian*

OFERTA  
SPECIALE

**Dotech**  
websites 

### KONTAKTONI

ADRESA E ZYRAVE:  
30 AVENONS ROAD  
LONDON, E13 8HT

020 7018 7929  
073 4066 5946  
078 5997 7545



# DW: RRITET PRESIONI NDAJ KOSOVËS PËR THEMELIMIN E ASOCIACIONIT

Gjatë kësaj jave është rritur më tej presioni ndaj Kosovës për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Ndhmëssekretari Amerikan i Shtetit, James O'Brien edhe Presidenti i Francës, Emmanuel Macron i kërkuan Kosovës që të përparojë urgjentisht drejt themelimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. O'Brien zhvilloi takim me kryeministrin, Albin Kurti në Gjermani, ku e siguroi se Shtetet të Bashkuara të Amerikës e mbështesin rugën e Kosovës drejt integriteteve euroatlantike, por Kosova duhet të zbatojë zotimet që dalin nga dialogu për normalizimin e raporteve me Serbinë.

“SHBA-ja mbështet rrugën e Kosovës drejt integriteteve euroatlantike. Për të lëvizur përpara ne na duhet zbatim i zotimeve të dialogut që ndërmjetësohet nga BE-ja, përfshirë edhe përparimin urgjent sa i përket Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe”, – shkroi O'Brien në platformën X, dhe shtoi se me kryeministrin Kurti diskutoi mbi hapat e nevojshëm pozitivë.

Ndhmëssekretari amerikan i Shtetit, James O'Brien para takimit me kryeministrin Kurti, ishte në Beograd ku takoi Presidentin e Serbisë, Aleksandar Vučić dhe nga atje tha se “Shtetet e Bashkuara do të bëjnë çdo gjë që është e mundur për të siguruar përmbushjen e zotimit të Kosovës për themelimin e Asociacionit”.

Macron thirrje për Asociacionin



Dy ditë më parë kryeministri i Kosovës Albin Kurti zhvilloi një bisedë telefonike me Presidentin e Francës Emmanuel Macron. Edhe ky i fundit ishte këmbëngulës në kërkesën e tij. “E theksova rëndësinë e përparimit të shpejtë dhe të pakthyeshëm nga autoritetet e Kosovës drejt themelimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në kuadër të përpjekjeve për anëtarësimin e saj në Këshillin e Evropës”, shkroi Macron në platformën X.

Kryeministri Kurti përmes një njoftimi “shprehu besimin e tij se Franca do të vazhdojë ta mbështesë anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës, pa parakushte shtesë, në përputhje me opinionin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës dhe votën historike të 16 prillit”. Kurti thotë në njoftimin e zyrës së tij se ai “nguli këmbë për respektimin dhe zbatimin e plotë të marrëveshjes së arritur vitin e kaluar” – për normalizimin e raporteve Kosovë-Serbi.

Draftstatuti i BE ende pa përgjigje

Bashkimi Evropian dhe SHBA-ja nuk kanë ndalur thirrjet ndaj Kosovës që ta themelojë Asociacionin dhe në këtë kuadër BE-ja i paraqiti muaj më parë Kosovës dhe Serbisë një draft-statut për Asociacionin, por deri tash nuk është ndërmarrë ndonjë hap drejt themelimit të tij. Vitin e shkuar, Kosova dhe Serbia u pajtuan për Marrëveshjen në rrugën drejt normalizimit, por kjo marrëveshje, sipas BE-së, nuk po zbatohet nga palët.

Serbia këmbëngul që Kosova ta themelojë Asociacionin ndërsa, Prishtina zyrtare kërkon nënshkrim të

marrëveshjes për normalizim me garanci ndërkombëtare, gjë që nënshkrimin e saj e refuzon Serbia. Marrëveshja e Ohrit ka 11 nene dhe ndër të tjera parasheh një nivel të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë, dhe njohje të ndërsjellë të simboleve shtetërore. Bashkimi Evropian dy ditë më parë e përfshiu zbatimin e marrëveshjes Kosovë-Serbi në kuadrin negociues të Serbisë për anëtarësim në BE.

Sidoqoftë, ka muaj që Prishtina dhe Beogradi nuk kanë zhvilluar takime në nivelin e lartë politik, por, palët dërguan në Bruksel kryenegociatorët. Një takim i tillë zhvillohet edhe këtë të enjte ndërmjet kryenegociatorëve Besnik Bislimi nga Kosova dhe Petar Petković nga Serbia. Ndërmjetësuesi i dialogut Miroslav Lajčak, para takimit shkroi se “është duke punuar për të gjetur një zgjidhje për çështjen e dinarit”, që Kosova e ndaloi përdorimin e tij në Kosovë në fillim të muajit shkurt. Në një përmbledhje të aktivitetëve të tij gjatë javës, Miroslav Lajčak, shkroi se “në takimet e fundit me kryenegociatorët, kanë arritur që ta ngushtojnë hendekun lidhur me këtë temë”, ndonëse akoma nuk është arritur marrëveshje. /DW


## ENVER ROBELLI

Më 24 prill 1987 – si sot para 37 vitesh – erdhi në Fushë Kosovë Sllobodan Millosheviqi. Deri në atë ditë ai ishte një aparatçik pothuaj i panjohur në Jugosllavi. Atë ditë u bë lider i serbëve. Ky ishte momenti kur u krijua miti i Millosheviqit si prijës i serbëve dhe Serbisë në betejën për Serbinë e Madhe dhe shkatërrimin e Jugosllavisë.

Millosheviqi iu drejtua serbëve lokalë, të cilët po ankoreshin se gjoja keqtrajtoheshin nga shqiptarët. Ndërsa lideri serb po fliste, jashtë godinës serbë të tjerë nisën të sulmojnë pjesëtarët e policisë (milicisë) së Kosovës, shumica e të cilëve ishin shqiptarë. Dikush nga serbët ia përçoi mesazhin Millosheviqit se policia po i keqtrajtonte serbët. Millosheviqi doli nga salla dhe iu drejtua serbëve lokalë me fjalinë: “Askush s’guxon t’ju rrahë!”

“Niko ne sme da vas bije!” është njëra nga fjalitë më famëkeqe që i parapriu luftërave në ish-Jugosllavi. Dy vite më vonë, më 28 qershor 1989, Millosheviqi mbajti në Gazimestan fjalimin e tij me rastin e 600-vjetorit të Betejës

# FJALIA QË NDRYSHOI GJITHÇKA



së Kosovës. Para udhëheqjes shtetërore gjithë-jugosllave të prirë nga Janez Dërnovsheku, kryetar i kryesisë së Jugosllavisë, Millosheviqi tha se “gjendemi para betejave, të cilat nuk janë duke u zhvilluar me

armë, ndonëse as beteja të tilla nuk përjashtohen”.

Në kujtimet e tij anëtari serb i presidencës jugosllave, Borisav Jović, shkruan se si pala serbe e bindi

Dërnovshekun të marrë pjesë në tubimin e Fushë Kosovës. Dërnovsheku frikësohej se Millosheviqi do të atakonte Sllloveninë gjatë fjalimit të tij.

“Unë i thashë”, shkruan Jović, “se mund të jetë i sigurt që ne nuk jemi të pakulturuar siç e imagjinojnë ata, që t’i ftojme si mysafirë dhe pastaj t’ua shajmë nënën”. Millosheviqi vërtet nuk ua shau nënën slllovenëve, por paralajmëroi luftë kundër popujve të tjerë të Jugosllavisë që do i dilnin përballë ambicieve të tij kriminale.

Më 24 prill 1987, në ditën kur Millosheviqi erdhi në Fushë Kosovë, komandant i njësisë policore kosovare ishte Destan Thaçi. Pas provokimeve dhe sulmeve të pareshtura nga serbët lokalë, të cilët vepruan sipas planit të orkestruar nga nëntoka politike e Beogradit, policia kosovare intervenoi dhe qetësoi situatën. Me heqjen arbitrare të autonomisë së Kosovës, Destan Thaçi u përjashtua nga puna si mijëra policë të tjerë të Kosovës.

Në histori asgjë nuk është përfundimtare: më 17 shkurt 2008 kolonel Destan Thaçi udhëhoqi operacionet policore në rajonin e Prishtinës. Dita e shpalljes së pavarësisë së Kosovës filloi e mbaroi pa asnjë incident.

DITMIR BUSHATI

Fundjavën e kaluar Irani ndërmori një sulm të drejtpërdrejt kundër Izraelit, përmes qindra dronëve dhe raketave nga territori i tij, duke nxjerrë në dritë luftën e gjatë që zhvillohet në hije midis dy armiqve rajonalë në Lindjen e Mesme. Kjo shfaqje force pasqyron një ndryshim në strategji nga Teherani, i cili është mbështetur në doktrinën e “durimit strategjik” dhe ndërmarrjes së sulmeve ndaj Izraelit përmes satelitëve të tij në Irak, Siri dhe Liban.

Irani përqafoi doktrinën e “durimit strategjik” pasi SHBA-të vranë komandantin Qasem Soleimani në Bagdad në vitin 2020. Që prej asaj kohe, Teherani është kujdesur të shmangë përplasjen e drejtpërdrejtë me SHBA-të dhe aleatët e saj në rajon. Madje, njoftoi administratën Trump përpara se të godiste objektivat amerikane në Irak, si kundërpërgjigje për vrasjen e ushtarakut të lartë.

Sulmi i drejtpërdrejtë ndaj Izraelit tregon gatishmërinë e Iranit për përplasje, por në një mënyrë të llogaritur pa shkaktuar një përshkallëzim dhe pa shkaktuar viktima. Në planin e brendshëm, gatishmëria dhe mobilizimi për luftë kundër Izraelit dhe aleatëve të tij asfikson lëvizjet e protestat që kërkohen ndryshime politike dhe më shumë të drejta civile në Iran. Në planin rajonal e ndërkombëtar, Irani nuk dëshiron të perceptohet si i dobët.

Pavarësisht sulmit ndaj Izraelit, strategjia afatgjatë e Iranit bazohet në hipotekimin e arritjeve gjatë dekadave të fundit dhe evitimin e luftës në shkallë të gjerë. Gjatë tri dekadave të fundit Irani është investuar në pasurimin e uraniumit për prodhimin e armëve bërthamore, mbështetjen e Hezbollah në Siri dhe Liban, mbështetjen e Hamasit. Ai është investuar gjithashtu në forcimin e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes me Rusinë, Kinën, Korenë e Veriut dhe Venezuelën.

Nga ana tjetër, Irani synon të arrijë një marrëveshje me SHBA-të dhe të njihet nga kjo e fundit si një fuqi kryesore rajonale. Ky objektivi qëndron në qendër të konfliktit edhe me Izraelin, i cili refuzon të njohë Iranin si një vend me ndikim të barabartë rajonal.

Pika e kthesës në raportet me Izraelin erdhi pasi ky i fundit lëshoi raketa në një kompleks diplomatik iranian në Damask, duke vranë disa ushtarakë të lartë të Iranit. Vështirë të thuhet nëse konsullata përmbushte ose jo kriteret e përcaktuara nga e drejta ndërkombëtare, për sa i përket mbrojtjes diplomatike. Gjithsesi, sulmi izraelit mbi godinën iranianë në Damask u konsiderua si një sulm “në tokën iranianë” nga Teherani. Pra, nga këndvështrimi i Iranit, ishte Izraeli që e kaloi vijën e kuqe dhe sulmi i fundjavës së kaluar nuk ishte gjë tjetër, veçse një kundërpërgjigje.

Vështruar në rrafshin historik, sulmi i

# SPIRALJA E RREZIKSHME E PËRSHKALLËZIMIT



Iranit kundër Izraelit përbën kërcënimin e parë serioz të jashtëm për sigurinë e Izraelit qysh se Saddam Hussein lëshoi raketat ndaj Izraelit në vitin 1991. Megjithatë, duhet thënë se kundërpërgjigja e Iranit ishte më tepër në funksion të “sederës së lënduar” së brendshmi për shkak të goditjes që i shkaktoi Izraeli në kompleksin diplomatik në Damask. Koreografia e sulmit iu bë e njohur më përpara SHBA-ve përmes Irakut dhe Turqisë për të minimizuar dëmin. Kjo i dha kohë Izraelit për të interceptuar dronët para se të arrinin në hapësirën ajrore izraelite dhe partnerëve të tij për të përsëritur angazhimin e hekurt për sigurinë e Izraelit.

SHBA-të dhe Mbretëria e Bashkuar përdorën sistemet antiraketore për të interceptuar raketat iraniane në hapësirën ajrore të Sirisë, Irakut dhe Jordanisë. Nuk ka ndonjë provë se Irani po synonte goditjen e aseteve të SHBA-ve apo Britanisë së Madhe të instaluar në rajon. Duket se Irani nuk ishte në kërkim të një përplasjeje me aleatët perëndimor të Izraelit.

Njoftimi paraprak, si dhe zgjedhja e objektiveve ushtarakë të sulmit sugjerojnë se Irani ishte i kalibruar në përçimin e mesazhit ndaj Izraelit, duke e konsideruar tanimë çështjen të mbyllur nga ana e tij. Të njëjtin skenar patën ndjekur SHBA-të në përgjigje të sulmeve të iranianëve ndaj pjesëtarëve të shërbimit amerikan në Jordani në fund të janarit. Ata pritën disa ditë për t’iu kundërpërgjigjur Teheranit përmes Irakut, duke u dhënë kohë iranianëve që të largonin forcat e tyre nga zona. Në të dyja rastet qëllimi nuk ishte përshkallëzimi, por rivendosja e kufirit të

parandalimit dhe adresimi i presionit të brendshëm në përgjigje të sulmeve, duke shmangur një konflikt rajonal në shkallë të gjerë.

Për Izraelin, agjenda subversive e Iranit është shumë e dukshme për t’u fshehur, e lere më të tolerohet. Irani nuk ka plane të ndalojë mbështetjen ndaj grupeve në rajon, që përbëjnë kërcënim serioz për Izraelin. Ndërtesa që Izraeli bombardoi në Damask shërbente si një qendër për planifikimin ushtarak. Eksperiencia jonë tregon se Irani përdor misionet diplomatike dhe qendrat kulturore për të përhapur ndikimin e tij malinj. Ushtroi sulme kibernetike për të dëmtuar infrastrukturën kritike. Gjithsesi, një gjë është e sigurt: që nga fundjava e kaluar, rregullat e angazhimit midis Izraelit dhe Iranit kanë ndryshuar.

Izraeli ishte mes dilemës për kundërpërgjigje dhe vetëpërmbytje. Gjasat që Izraeli do të përgjigjej për të dëshmuar se sulme të kësaj natyre nuk mund të tolerohen në të ardhmen, duke peshuar përfitimet e kundërpërgjigjes përkundërt thirrjeve të aleatëve të tij për çtensionimin e situatës, ishin të mëdha. Sulmi ajror i Izraelit afër bazës ajrore të Iranit në Provincën e Isfahanit është zbatim strikt e i pashmangshëm i logjikës së kundërpërgjigjes, pasi kemi të bëjmë me goditjen e një baze ajrore nga e cila u lëshuan dronët iranianë kundër Izraelit. Sipas medias shtetërore iraniane, dëmet janë të papërfillshme. Ndërkohë që Izraeli ka zgjedhur heshtjen.

Më shumë se sa një goditje frontale në tokën iranianë, që do të zgjeronte

në mënyrë dramatike konfliktin, kemi të bëjmë me një përgjigje të kalibruar që mund të lexohet si “administrim i përshkallëzimit të konfliktit”. Thënë ndryshe, përpjekja izraelite për t’u kundërpërgjigjur pa shkaktuar përshkallëzim të mëtejshëm ka qenë e suksesshme. Zgjerimi i konfliktit nuk është në interes të rajonit dhe aleatëve që mbështesin Izraelin. Sidomos në kushtet kur SHBA-të janë në prag të zgjedhjeve presidenciale.

Në kushtet e krijuara së fundmi, kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu ka fituar një hapësirë për frymëmarrje politike së brendshmi, pas një vale të gjatë protestash të organizuara kundër planeve të tij për të kufizuar rolin e drejtësisë për t’u shpëtuar proceseve gjyqësore dhe luftës së ndërmarrë në Gaza, e cila ka shkaktuar dëme njerëzore e materiale të pallogaritshme.

Gaza dhe civilët janë humbësit e mëdhenj të situatës së re, pasi vëmendja ndërkombëtare është zhvendosur drejt shmangies së një përshkallëzimi që do të çonte në një luftë rajonale. Megjithëse rrënjët e përhapjes së konfliktit në Lindje të Mesme janë në Gaza dhe në dështimin e shtrëngimit të rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së, që kërkon armëpushim të menjëhershëm dhe lirin e pengjeve, situata që nga 7 tetori i vitit të kaluar mbetet dramatike.

Për SHBA-të, frenimi i ambicieve të Iranit në rajon është një çështje parësore. Projekti bërthamor iranian si edhe përpjekjet e Iranit për të riformtuar rajonin sipas dëshirës së tij përbëjnë shqetësime kryesore për Washingtonin. Në këtë këndvështrim

duhen lexuar veprimet energjike të Washingtonit gjatë fundjavës, të cilat synojnë fuqizimin e aleatëve në Lindje të Mesme dhe njëkohësisht shmangien e viktimitave.

Pasojat e konfliktit në Lindje të Mesme ndihen në Europë më shumë se kudo, për shkak të afërsisë gjeografike. Që prej luftës në Siri në vitin 2015, brenda BE-së ka një debat të madh për sa u përket valëve të refugjatëve dhe pranimit ose jo të “ndryshmit”. Paradoksisht, rindezja e konfliktit në Lindje të Mesme është shoqëruar edhe me rritje të antisemitizmit, edhe me rritje të islamofobisë në Europë, të cilat shërbejnë si karburant për partitë e ekstremit të djathtë e të majtë në një vit zgjedhjesh për në Parlamentin European.

Megjithëse deri tani arti i diplomacisë ka rezultuar efektiv në administrimin e ciklit të rrezikshëm të përshkallëzimit, situata në Lindjen e Mesme na sjell në vëmendje Luftën e Parë Botërore, e cila shpërtheu jo se palët ndërluftuese e donin atë, por sepse nuk ishin të gatshëm të hiqnin dorë nga spiralja e rrezikshme e përshkallëzimit të konfliktit. Vështruar në këtë kontekst, parandalimi i përshkallëzimit të konfliktit, armëpushimi i menjëhershëm dhe liri i pengjeve në Gaza, ndërtimi i një arkitekture të sigurisë në Lindjen e Mesme që siguron raporte normale mes vendeve arabe dhe Izraelit, e njëkohësisht parashtron hartën e rrugës për krijimin e shtetit palestinez janë alternativa e vetme përkundërt luftës.

**\*Analiza është botim i Fondacionit “Friedrich Ebert”**

LUTFI DERVISHI

# NAFTA E SHPIRAGUT SI RAKI BALLË KAZANI

Nëse s'do të ishim dëshmitarë të gjallë të këtyre kohëve, subjekti i këtij shkrimi mbase do dukej si një skenë e trilluar e marrë direkt nga një film komedi. Gjithçka nis kur nga goja e kryeministrit dëgjuam atë që deri në atë moment e kishim hasur veç në rrëfime sharlatanësh që sytë i kanë shndërruar në dedektorë për gjëra që ekzistojnë veç në mendjen e tyre. Nuk ishin të paktë ata që u mrekulluan kur dëgjuan lajmin që do ndryshonte jetë të tëra njerëzore: Shpiragu ishte plot me ar të zi. Naftë! E jo naftë dosido, fantazia shkante më tutje: Naftë cilësia e parë, ballë kazan!

Kryeministri dhe Ministria dolën me fanfara për të njoftuar se Shqipëria së shpejti do të ishte aq e mbushur me para sa që do të kishte nevojë për një fond sovran për të menaxhuar të gjitha të ardhurat.

Por si në çdo përrallë të bukur vjen një moment kthese kur realiteti të detyron të zgjohesh. Pas shpenzimit modest të 600 milionë dollarëve në kërkime, Shell njofton se rezultati është... pothuajse i njëjtë me atë që merr kur kërkon monedhën e rënë në "të çarën" e divanit. Absolutisht, të gjithë do të donin që rezultatet të mos ishin këto dhe njëkohësisht që titullarët mos i trajtonin njerëzit si të ishin laborator ku eksperimentojnë ëndrrat e tyre në kufij me gënjeshtër. Në një botë ideale, kjo histori do të shërbente si një mësim i çmuar për qeverinë: Jo çdo gjë që shkëlqen është ar (i zi) dhe... heronjtë e përrallave moderne duhet të jenë pak më të kujdesshëm me premtime

parazjedhore që tingëllojnë si "hapu Sezam". Është mirë që shpesh të hapin librin e proverbave dhe të lexojnë: "Peshku në det, tigani në zjarr!", apo "Më mirë një zog në dorë se 100 që fluturojnë!". Kryeministri, i cili kishte paralajmëruar një epokë të re prosperiteti falë Shpiragut, tani do të duhet të jetë gati për një tjetër vëllim rrefenjash. Nëse dekada e Sudes dhe e Xhaferrit do vazhdojë të stërzgjetet kaq pafundësisht, atëherë një tjetër "Shpirag" do të shfaqet.

Nuk thonë kot: Zoti me një dorë të hedh dhe me tjetrën të pret. Një zbulim i ri pritet që këtë radhë jo vetëm të ndryshojë fatet e vendit, por edhe të mbarë rajonit dhe botës: Është

hidrogjeni në Bulqizë. Ky qytet mbetet i njohur më shumë për varfërinë dhe viktimat se sa për pasurinë e tij që vetëm vret, ku në një anë të pasurit numërojnë vagonat e kromit, të varfërit numërojnë arkivolet e viktimave. Megjithatë, pas dështimit në Shpirag, qeveria me lugën bosh në brez i ka gati planet për të shpallur Bulqizën si "Kuwaitin e Ri" të Ballkanit "Shihni, nuk ka rëndësi se nuk gjetëm naftë në Shpirag; ne kemi tani - H2 në Bulqizë!" mund të imagjinohet duke thënë Kryeministri me syzet në kokë, duke i dhënë një kthesë të papritur ngjarjeve që çuditërisht ndodhin para zgjedhjeve. "Hidrogjeni është e ardhmja, dhe Shqipëria do të jetë lideri i këtij rev-

olucionit të gjelbër. Hidrogjeni nuk është vetëm i lehtë, por është i pastër. Aq i pastër sa që njerëzit në këtë vend nuk do të thithin oksigjen (O2), por hidrogjen (H2)". Ndërsa skeptikët (që nuk i kanë munguar asnjëherë këtij vendi), thonë se Bulqiza është episodi i radhës në serialin e pafund të "Teatrit të Gaztorëve", disa janë të bindur se këtë herë qeveria ka të drejtë. A është Hidrogjeni në Bulqizë shpëtimi që të gjithë kanë pritur, apo thjesht një tjetër iluzion në reperitorin e larmishëm të qeverisë? E sigurt është vetëm një gjë: Në këtë teatër gaztorësh, askush nuk mund të thotë që nuk është argëtuar e do argëtohet, pasi për ta përtypur këtë realitet zgjidhja që ka mbetur është të qeshësh!

# AKOMA NUK KENI BUSINESS CARDS?

NA KONTAKTONI:  
020 7018 7929  
073 4066 5946  
078 5997 7545

PËR ÇDO KONSULTIM MUND TE VINI NË ÇDO KOHË NË ZYRAT TONA  
ADRESA E ZYRAVE: 30 AVENONS ROAD, LONDON, E13 8HT


The image displays a collection of business cards for various construction and renovation companies. Each card includes a QR code, the company name, and contact details such as phone numbers, email addresses, and websites. The cards are arranged in a grid-like fashion, showcasing a wide range of services including roofing, scaffolding, landscaping, and general building work.

BUSINESS CARDS ME QR CODE

ZGJIDHNI PROFESIONISTËT PËR SUKESIN E KOMPANISË TUAJ

# POROSISNI BUSINESS CARDS

**Dotech** websites



**Websites 01**

**Business Cards 02**

**Banners 03**

**Marketing 04**



**020 7018 7929**  
**073 4066 5946**  
**078 5997 7545**



**ADRESA E ZYRAVE:**  
**30 AVENONS ROAD**  
**LONDON, E13 8HT**

Paraja serbe të dërgohet në një bankë serbe në Kosovë nga e cila shërbimi serb i postës së shpejtë do ta dorëzojë zarfin serb në duart e marrësit serb; njëri prej koncepteve që prek edhe në Srebrenicë e Banjskë

## VETON SURROI

1.

Serbia është duke gropuar më thellë gropën në të cilën gjendet dhe nga e cila do ta ketë gjithnjë e më vështirë të dalë. Për ta shpjeguar gropën po e ofroj një fjalë të re që nuk gjendet në fjalorin e gjuhës shqipe dhe ajo është veçantizëm. Fjala veçantizëm është adaptim nga termi anglisht “exceptionalism” i cili po ashtu lindi si përshkrim i një fenomeni duke zgjatur me -ism fjalën “exceptional”, pra të jashtëzakonshëm apo në këtë rast të veçantë. Kështu, veçantizmi në këtë rast është shprehja e një besimi kolektiv se një grupim (komb, shtet, institucion) është i një natyre të veçantë prej grupeve të tjera të natyrës njerëzore dhe rrjedhojë e këtij besimi jo rralë është edhe ndjenja e epërsisë.

“Veçantizmi” serb ka histori të gjatë ndërtimi, por momenti i shndërrimit në një besim kolektiv të shumicës ishte vala e nacionalizmit të cilës i printe Slobodan Milosheviqi, që deklaroi se kombi serb nuk mund të jetë pakicë askund në Jugosllavi. Ky formulim, i cili u shndërrua në besim kolektiv që përshkonte edhe dallimet pushtet-opozitë në Serbi deklaroi se ekziston një “veçanti” tek serbët që nuk lejon që të jetë pakicë politike edhe kur është pakicë numerike. Qytetari me përkatësi serbe nuk mund të jetë pakicë në Serbi, Bosnjë-Hercegovinë dhe natyrisht Kosovë (prej nga ka origjinën ky besim në ligjërimin nationalist serb), por ka natyrë prej “kombi konstituent”, themeltar. Prej këtij definicioni tek luftërat e përgjakshme të zhbërjes së Jugosllavisë duhej rrugë e shkurtër; nga këndvështrimi i këtij besimi serbët, duke qenë të veçantë, kishin të drejtë të zhvillonin luftë të armatosur kundër popujve të tjerë për ta mbrojtur këtë veçanti. Prej kësaj pike në supremacizëm, besimi në epërsinë e popullit serb ndaj popujve të tjerë është rrugë edhe më e shkurtër që jep arsytim shtesë për ushtrimin e dhunës ndaj të tjerëve, të atyre që janë “poshtë”.

2.

Veçantizmi fshihet në vende të paimagjinueshme, ja për shembull në çështjen e qarkullimit të pagesave. Prej vitit të kaluar kur autoritetet e Kosovës shpallën të paligjshëm qarkullimin e dinarit si para e gatshme (monedhë, kartëmonedhë, mjet elektronik i pagesës në qarkullimin e brendshëm), njëra prej pasojave të

# “VEÇANTIZMI”, GROPA NË TË CILËN PO ZHYTET SERBIA



drejtpërdrejta (dhe të padëshiruara e padëshirueshme) ishte që një pjesë e popullatës serbe në Kosovë që kishte marrë rroga, paga apo pensione me dinarë kishte vështirësi që këto para t'i marrë në euro, ashtu siç kërkon rregullorja e BQK-së. Në katër muajt e kaluar janë zhvilluar disa iniciativa diplomatike për gjetjen e një zgjidhjeje, qoftë edhe të përkohshme dhe gjatë kësaj periudhe Serbia zyrtare ka ndërtuar një koncept zgjidhjeje që është pjesë e veçantizmit. Sipas projektit të Beogradit duhet të ndërtohet (sërish) një komunikim financiar vertikal me të cilin paraja serbe (dinari) do të dërgohet në një bankë serbe në Kosovë nga e cila shërbimi serb i postës së shpejtë do ta dorëzojë zarfin serb në duart e marrësit serb.

Natyrisht, ekziston një zgjidhje që është normale dhe që është më e afërt me konceptin e parasë dhe qarkullimit të saj - paraja është e depersonalizuar dhe deetnizuar e qarkullimi i parasë për nga natyra duhet të jetë tejkalues i barrierave etnike, shtetërore, ideologjike dhe çdo tjetër nëse do të jetë i suksesshëm. Kjo zgjidhje normale është që shteti i Serbisë që dëshiron të ndihmojë qytetarët serbë në Kosovë për qëllime legjitime (humanitare, nxitje arsimit, shëndetësie, kulture, etj.) të dërgojë para brenda sistemit bankar të pagesave dhe që ato para të arrijnë në duart të marrësve qoftë nëpërmjet llogarive bankare apo dërgesave postale (private e publike).

Por ky sistem nuk po pëlqehet nga Serbia, sepse dëmton parimin e veçantisë, gjegjësisht ideologjinë e veçantizmit. Paraja duhet të jetë serbe, banka serbe dhe posta serbe, në mënyrë që të arrijë në duart serbe të

marrësit.

3.

Veçimi etnik i parasë, bankave e postave - të qarkullimit financiar pra - ndërtohet si parim edhe në fusha të tjera, si për shembull në sundim të ligjit apo diplomaci. Brenda disa muajve Serbia zyrtare ofroi një kundrim krejtësisht të veçantë lidhur me Rezolutën e planifikuar për Srebrenicën në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së e përgjegjësive e sulmit paraushtarak në Banjskë të Kosovës.

Rreth Srebrenicës Serbia ka ngritur argumentin se aty nuk është kryer gjenocid (me gjithë aktgjykimet e plotfuqishme të gjykatave më të larta të OKB-së, pra të verdikëve që kanë vlerë të plotë në të drejtën ndërkombëtare). Argumenti ndërtohet me pikënisje të ndryshme, por që arrijnë në rezultat të njëjtë: serbët nuk janë popull që kanë mundur të kryenin gjenocid. Ky rezultat arrihet duke thënë se në luftërat e ish-Jugosllavisë janë vrarë edhe serbët, se Gjermania në Luftën e Parë dhe të Dytë Botërore ka vrarë më shumë njerëz sesa kanë vrarë serbët në Srebrenicë, e kështu me radhë, deri në nivele gjithnjë e më të larta të absurdit. Por, rezultati i këtij ligjërimi është se për dallim prej gjermanëve (që në ligjërim janë përgjegjës për Holokaust), turqve (“përgjegjës për gjenocidin ndaj armenëve”), në Srebrenicë nuk ka ndodhur gjenocid, sepse serbët “mund të kenë kryer krime të tmerrshme, si edhe të tjerët”, por nuk mund të kryejnë gjenocid. Kështu, ekziston një veçori që nuk e lejon serbin etnik të kryejë gjenocid, por kjo veçori nuk

ekziston tek popujt e tjerë, madje me zhvillim shumë më të madh kulturor, politik e ekonomik në kontinentin evropian, siç janë gjermanët.

Në rastin e Banjskës, gjegjësisht sulmit paraushtarak të prirë nga Milan Radoiçiqi, dilema për Serbinë zyrtare është se a mund të cilësohet një serb që merr armë kundër pushtetit të Kosovës veprim i paligjshëm? Apo, në kontekstin e normave e ligjeve evropiane (përfshirë edhe ato të Serbisë), a mund të cilësohet si shkelje e ligjit kur një serb organizon veprime të dhunshme kundër Kosovës (e shqiptarëve)? Prej sulmit në Banjskë kanë kaluar shtatë muaj dhe deri më tani Serbia ka deklaruar me veprime se ligjet zbatohen kundër çdo veprimi të dhunshëm, pos nëse veprimi i dhunshëm është i një qytetari etnik serb, i cili detyron me armë pjesëtarët e kombeve e shteteve të tjera të besojnë se ekziston veçantizmi serb dhe se ata duhet t'i nënshtrohen atij. Këtë Serbia e tregoi që nga dita e parë pas sulmit paraushtarak, duke shpallur ditë zie për pjesëtarët e vrarë të formacionit paraushtarak që sulmoi Kosovën.

Qytetari etnik serb që komandon vrasjen e tetë mijë djemve dhe burrave në Srebrenicë apo ai që i prin një aksioni paraushtarak kundër Kosovës nuk mund të jenë duke kryer vepra kundërligjore, sepse janë duke mbrojtur të drejtën e veçantisë serbe.

4.

Pra, del që në veçantizmin serb ekziston një interpretim krejtësisht i ndarë (a të përsëritemi-i veçantë) i ligjeve financiare, të verdikëve të gjykatave ndërkombëtare e të kodeve penale që në nivel evropian janë pothuajse të unifikuara. Një qytetar portugez nuk do të kërkojë bankomat etnik grek për të nxjerrë para. Një qytetar estonez nuk do të kërkojë që vendimet e gjykatave të arbitrazhit të jenë të vlefshme vetëm nëse në to si palë e dënuar nuk përmenden Estonia e estonezët. Një qytetar austriak nuk do të kërkojë që kodi penal i Austrisë të jetë i aplikueshëm çdoherë pos në rastet kur qytetari austriak, në mbrojtje të kulturës dhe historisë austriake gjuan me revole dhe automatik çdokënd që mohon epërsinë e Austrisë e austriakëve ndaj popujve të tjerë fqinj. Por, që të gjitha këto përjashtime kërkojnë në Serbi.

Serbia ka hyrë në një gropë, jo tash, por prej kohës së konsensusit nacionalist të kohës së Milosheviqit. Gropa e veçantisë nuk është vetëm ndaj popujve fqinj, por, siç shihet, edhe ndaj botës në tërësi. Ashtu siç është bërë përpjekja që popujt fqinjë ta pranojnë qoftë edhe me dhunë realitetin e veçantisë së Serbisë e serbizmit, ashtu është bërë përpjekja e po

bëhet edhe sot që bota ta shohë veten nëpërmjet syve të veçantizmit serb. Formulimin më të mirë e bënë në diskutimet e Këshillit të Evropës disa deputete serbe që përsëritën ligjërimin udhëheqës në vend - politik e mediatik - duke iu drejtuar kolegëve në Këshill të Evropës: “Si guxon ta pranonin në mesin tuaj Kosovën?”, që i bie pak a shumë “Si guxonin mos ta shihni Kosovën me sytë tanë?”.

Gropa e thellë e izolimit nga realiteti në të cilën gjendet Serbia vazhdon të thellohet; Serbia e ka marrë me seriozitet lopatën e rrëmihjes drejt thellësive të reja. Ky natyrisht nuk është lajm i mirë për Serbinë dhe, siç ka ndodhur gjithëherë në këtë regjion, nuk është lajm i mirë as për fqinjët e saj.

5.

Në këtë shkrim nuk u përmendën “veçantizmat” e të tjerëve. Është e qartë se si fenomen ekzistojnë. Çdoherë që përmendet një krim që mund të jetë kryer nga ndonjë shqiptar i armatosur në Kosovë me apo uniformë të UÇK-së, ligjërimi veçantist në Kosovë do të deklarojë se “lufta e shqiptarëve” (apo UÇK-së) ishte e pastër, rrjedhimisht ekziston pamundësia pothuajse biologjike që një shqiptar të kryejë krime ndaj civilëve serbë.

Apo, sikurse edhe në Kosovë, çdoherë që përmendet ndonjë krim i kryer nga pjesëtar i forcave të armatosura kroate ndaj civilëve serbë do të ngrihet ligjërimi veçantist, i cili do të thotë se nuk mund të krahasohen krimet e Serbisë e Serbosllavisë me krimet eventuale që i kanë kryer “çlirimtarët”, me çka ekziston e drejta sipërore për të vrarë civilë nëse qëllimi është i mirë, gjë që eventualisht çon te legjitimitimi i vrasjes së civilëve.

Por, Kosova është shoqëri që me gjithë traumat e saj po kalon edhe me një gjykim të disa prej krerëve të UÇK-së. Në të vrasja e civilëve nuk po trajtohet, as nga prokuroria e as nga të akuzuarit, si një e drejtë e veçantizmit. E kush dyshon në kulturën e ballafaqimit me të kaluarën në Kroaci mund të ketë parë gjatë kësaj jave krerët e shtetit të Kroacisë, figura të pushtetit e të opozitës, të cilët shkuan me lule në duar në kampin fatkeq të Jasenovcit dhe te varrezat e romëve të vrarë nga pushteti fashist kroat gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Dhe, ja pse “veçantizmi” i të tjerëve – për shembull shqiptarëve e kroatëve - nuk u përmendën në një gjerësi e thellësi sikur në rastin e Serbisë. Në Serbi ky është ende e për fat të keq jo vetëm projekt shtetëror, por në masë të madhe edhe shoqëror.

SHABAN MURATI

Presidentja e Greqisë K. Sakellariopoulou evokoi në 24 prill 2024 të ashtuquajturin gjenocid armen të vitit 1915. E kishte më lehtë të mos shkonte aq larg deri në Armeni, por të shkonte në shtetin fqinj Shqipëri, ku këtë vit është 110 vjetori i gjenocidit grek, kur ushtria greke dhe bandat ushtarake greke masakruan me dhjetra mijëra banorë shqiptarë në Gjirokastër, në Tepelenë, në Përmet, në Ersekë, në Korçë, në Skrapar, në Berat, etj.

Sipas shkencëtarëve gjermanë, vetëm në Gjirokastër forcat greke masakruan 20 mijë banorë shqiptarë. Ishte një gjenocid shtetëror etnik dhe fetar, që synonte spastrimin etnik të popullsisë shqiptare të Jugut të Shqipërisë, të pushtuar nga ushtria greke.

Presidentja greke mund dhe duhet t'u kërkonte falje Shqipërisë dhe popullit shqiptar në këtë 110 vjetor të gjenocidit grek mbi popullsinë civile shqiptare. Presidentja geke nuk e bëri dhe nuk e ka bërë asnjë president apo kryeministër grek që nga 1914 e deri në ditët tona.

Mirë Athina nuk e ka bërë dhe nuk e bën dhe i ka vënë kapakun shtetëror

## KUR DO KETË TIRANA GUXIMIN T'I KUJTOJË ATHINËS GJENOCIDIN GREK NË SHQIPËRI NË 1914?



të varrit të vërtetës historike, sepse shtetin vrasës nuk e vret ndërgjegjia ndërkombëtare dhe as morali ndërkombëtar, po Tirana kur do të ngrihet t'ia kujtojë Athinës këtë gjenocid grek mbi popullsinë shqiptare? Edhe dele të kishin qenë ata dhjetëra mijëra gra, fëmijë e pleq të masakruar në mënyrë masive nga ushtria greke në territorin shqiptar, Tirana duhet t'i kishte kërkuar repara-

cione Greqisë.

Unë nuk e di nëse kryeministrat shqiptarë të tranzicionit e kanë lexuar kryeveprën e historianit, priftit dhe patriotit të madh shqiptar, Papa Kosta Tomorri, i cili si dëshmitar okular i gjenocidit grek botoi në SHBA qysh në vitin 1917 librin e famshëm "Barbaritë greke në Shqipëri".

Nuk e di nëse udhëheqësit e Shqipërisë e njohin historinë e shtetit të tyre dhe nëse e kanë lexuar që paraardhësi i tyre, kryeministri i Shqipërisë, Turhan Pashë Përmeti, kërkoi zyrtarisht në Konferencën e Paqes në Paris në 1919 reparacione nga Greqia për masakrat dhe shkatërrimet në qytetet dhe fshatrat në Shqipëri në vitin 1914.

Sivjet është 110 vjetori i gjenocidit grek në Shqipërinë e Jugut. Kaloi një e treta e vitit dhe nuk shihet gjëkund që Tirana të organizojë sesione përkujtimore, konferenca apo mbledhje solemne zyrtare dhe akademike për këtë ngjarje tragjike të historisë shqiptare. Tirana nuk po ngre një memorial në kryeqytet në përkujtim të dhjetëra e dhjetëra mijëra shqiptarëve të masakruar gjatë gjenocidit grek.

Tirana ndërkohë i ka dhënë lejen Greqisë të ndërtojë në territorin e Shqipërisë së Jugut katër varreza të mëdha greke për të nderuar ushtarët e ushtrive pushtuese greke. Tirana, që nuk ka ngritur një memorial për dhjetëra e dhjetëra mijëra të vrarët

shqiptarë në gjenocidit grek të 1914, nuk ndërton asgjë për të përkujtuar holokaustin e popullit të vet, po ndërton në mënyrë absurde dy muzeume në Tiranë dhe në Vlorë për holokaustin çifut, sepse kështu iu tek kryeministrat aktual internacionalist të Shqipërisë.

Dhe që turpi shtetëror e qeveritar të arrijë kulmin botëror, kemi faktin e turpshëm që autoritetet shqiptare nuk lejojnë dhe nuk japin të ashtuquajturën leje ndërtimi për memorialin në kujtim të 217 banorëve shqiptarë të masakruar nga forcat greke vetëm në fshatin Hormovë në vitin 1914.

Tirana nuk po guxon t'ua kujtojë presidentes greke apo kryeministrat grek se duhet t'u kërkojnë falje Shqipërisë dhe popullit shqiptar për gjenocidit grek në Shqipëri. Gjaku dhe memoria e dhjetëra e dhjetëra mijëra qytetarëve shqiptarë në këtë 110 vjetor historik të holokaustit shqiptar duhet t'u prishin gjumin e inferioritetit diplomatik qeverisë dhe diplomacisë së Shqipërisë

ROMIR SARAÇI

"McGonigal developed a relationship with Prime Minister Rama and took steps to benefit the ..." "Wie die Mafia in Albanien Wahlen manipuliert" ... "(Hot)Spot Albanese" ...

Shqipëria, falë qeverisë dhe kryeministrit Edi Rama, arriti të jetë ndër vendet me të komentuar, pas atyre në luftë, në gjuhë të ndryshme të botës, për skandalet që veç në gjuhën shqipe nuk marrin peshën e merituar. Pasi pa që çudia nuk kishte gjasa të zgjaste veç 3 ditë, kryeministri nisi të vepronte siç përditë me puthadorët e tij shqiptarë, duke marrë në telefon drejtorin e RAI 3, ku sipas La Repubblica shfrytëzimin e tij. E ndërsa nën rogoz përdorte metodat që kanë zhytur Shqipërinë gjithnjë e më poshtë në raportet e lirisë së medias, në publik nisi zbatimin e strategjisë së dalë boje tashmë. Sulme dhe zhvlerësimi i gazetarëve që tentojnë t'i transmetojnë opinionit publik disa prova të shkruara e zeza mbi të bardhë, e jo "copy paste" të ofruara çdo ditë nga ministria e propagandës nëpërmjet kolektorëve mediaticë. Fushatën e nisi vetë kryeministri, që ngriti siparin e sulmeve ndaj gazetarëve të RAI 3, por edhe Syri TV, si e vetmja dritare që vijon të rezistojë në misionin e shërbëtorit të qytetarit e jo të pushtetit. Pas shfrytësimit të tërbimit nga Rama, stafetën e morën ata që kryeministri i cilëson "miq të sukseseve të qeverisë". Me metoda komuniste, siç

## CARO RAMA DHE KOLEKTORËT PRIMITIVË MEDIATIKË!



në romanin 1984 të Xhorxh Oruell, nisi lavazhi i trurit. Dashuria për "vëllanë e madh" verbon konstatimin e mjerimit ku po zhytet vendi për shkak të qeverisjes mafioze, korrupsionit dhe shitjes së vendit për hir të mbështetjes ndërkombëtare që zgjat pushtetin. Lajmëtarët pranë qeverisë nisën talljen me inteligjencën e shqiptarëve, se denoncimi në gjuhën italiane është një dëmtim i imazhit të Shqipërisë, ndaj duhet refuzuar, e besimi të "babai i kombit" nuk duhet

lëkundur. Sforcohen të thonë se gazetaret italianë nuk janë treguar profesionistë, pasi nuk kanë tentuar të marrin reagimin e palës tjetër, pra të kryeministrat Edi Rama dhe Engjëll Agaçi, por refuzojnë t'i thonë opinionit se kolegu i tyre Giorgio Mottola rrezikoi jetën duke vrapsuar mes gardës për t'i marrë një reagim Agaçi, e ishte po ai gazetar që u refuzua me ironi nga kryeministri Edi Rama, teksa kërkonte të ndërkombëtarizohej kur parakalonte mbi tapetin

e kuq të korrupsionit në Samitin e shkurtit.

Kulmi i mbrojtjes së qeverisë dhe sulmimit të kolegëve italianë arrin me justifikimin e marrjes së mijëra hektarë toke në bregdet nga një i cilësuar ndërkombëtarisht si bos i mafias shqiptare. Për gazetaret e RAI 3, marrja e këtyre pronave për llogari të shëfit të INTERPOL është një rast i dyshuar korruptiv nga Fabrizio Lisi, i cili kur Shqipëria mbulohej nga kanabisi prodhonte raporte të Guardia di Finanza, se kanabisi ishte veç një hamendësim i opozitës dhe gazetarëve. Ndërsa Lisi u arrestua nga autoritetet italiane për pengim të hetimeve, më së shumti për dosjet që lidhen me Shqipërinë, gazetaret me pasaportë shqiptare përpiqen ta shenjtërojnë, me argumentin se prona që do të merrej nga mafiozi Artur Shehu do të përdorej për bamirësi. Kulmi!

Ndërsa ish-gjenerali Lisi i arrestuar në Itali tentohet të shenjtërohet, një prej ikonave të drejtësisë italiane, prokurori i antimafias Francesco Mandoi baltoset alla shqiptarçe si i kapur politikisht, e se nuk e nje Vettingun e Edi Ramës në Shqipëri. Këtu, "manjakët e detajeve" tregohen gazetarë amatorë, duke anashkaluar

faktin se ky "militanti" anti-Rama, u kontraktua nga kryeministri shqiptar në nisje të Reformës në Drejtësi, por nuk u pyet më kurrë, pasi nuk ishte kategoria e atyre që shesin raporte e këshilla sipas oreksit të ditës.

Këta rrugëhumbur nga misioni i shenjtë i gazetarit, të paktën, nëse duan të mbeten seriozë, duhet të bëjnë avokatin e qeverisë me prova dhe jo me përshtypje personale.

E veç seriozitet nuk mund të ketë, kur në denoncimin e zhytjes së qeverisë në korrupsion e lidhje mafioze, kryeministri shqiptar trajtohet si dëm kolateral sepse objektiv sulmi ishte Georgia Meloni, duke anashkaluar totalisht faktet ulëritëse.

Ndoshta, zgjidhja e këtyre problemeve nuk vjen nga të mësuarit shqip e gazetarëve italianë, gjermanë e amerikanë, mbase me produktive do të ishte të mësuarit italisht, anglisht e gjermanisht nga shqiptarët, pasi në këtë mënyrë do të bënin me mirë dallimin e të menduarit si gazetar italian e të vepruarit si biznesmen shqiptar. Që më pas të mos na shiten si patriotë që u djeg barku për imazhin e Shqipërisë.



**For Sale**



**PËR SHITJE**

**Shitet nje restorant  
i rinovuar ne nje nga  
zonat me te frekuentuara  
te Northamptonit  
I pajisur me të gjitha  
licencat  
I hapur deri ne oret e  
vona.**

**Ne fundjave deri ne ora  
3 am**


**Çmimi shumë  
i arsyeshëm**

**Mundesi fantastike per  
zhvillimin e biznesit**

**Për më shumë info tel:  
07460 112833**



**For Sale**



**For Sale**



**For Sale**

# AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

**Dotech**  
website 

## AKOMA NUK JENI REGJISTRUAR NË GOOGLE?

**Ne mund t'iu  
ndihmojme edhe me:**

**Business Cards**

**Logos**

**Banners**

**Video Marketing**

**Adresa e zyrave**



**30 Avenons Road,  
London E13 8HT**



**020 7018 7929**

**073 4066 5946**

**078 5997 7545**

